



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:
“Ekonomiks dhe Financë” me profile “Ekonomiks”, “Financë” dhe
“Kontabilitet”
"Universiteti i New York-ut në Tiranë"**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Dorina Kripa

Prof. Asoc. Elida Liko

Shtator / 2023

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në: “Ekonomiks dhe Financë” me profile “Ekonomiks”, “Financë” dhe “Kontabilitet”**

1	IAL aplikues:	"Universiteti i New York-ut në Tiranë"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Ekonomiks dhe Financë” me profile “Ekonomiks”, “Financë”, dhe “Kontabilitet”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër nr. 212 datë 03.07.2020
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	Tre vite akademike / 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Angleze
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	13 PAE / 4 PAK Për sa i përket ngarkesës mësimore 87 % PAE- 13 % PAK
18	Numri i studentëve:	Profili: Kontabilitet 2020-2021 2 studentë 2021-2022 1 student 2022-2023 0 studentë Profili :Financë 2020-2021 1 student 2021-2022 18 studentë 2022-2023 11 studentë

		Profili :Ekonomiks 2020-2021 3 studentë 2021-2022 2 studentë 2022-2023 1 student
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Bachelor në “Ekonomiks dhe Financë” me profile “Ekonomiks”, “Financë” dhe “Kontabilitet”, ofrohet nga Universiteti i New York -ut në Tiranë, i pari universtitet privat i themeluar në vitin 2002. Aktualisht Universiteti i New York-ut në Tiranë përbëhet nga katër njësi kryesore:

1. **Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit;**
2. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore;
3. Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës;
4. Instituti për Kërkime Europiane dhe Ballkanike;

Programi i studimit, është hapur fillimisht sipas VKM Nr. 397, datë 15.08.2002, si Bachelor në Administrim Biznesi me profile: a.Kontabilitet; b.Financë; c.Marketing; ç.Menaxhim; d. Ekonomiks. Ky program studimi është riorganizuar nga Bsc ne Mp me Shkrese nga MAS me Nr. 6858/2 prot, date 06.05.2011. Me shkresë të MASR nr. 2160/1, datë 23.03.2018, ky program studimi riorganizohet si Bachelor në Administrim Biznesi me profile: a.Kontabilitet; b.Financë; c.Marketing; ç.Menaxhim; d. Ekonomiks, me 256 kredite, dhe me kohëzgjatje 4 vite akademike. Referuar Urdhërit të MASR Nr. 212, datë 03.07.2020 ky program studimi riorganizohet nga Bachelor në Administrim Biznesi me profile: a.Kontabilitet; b.Financë; c.Marketing; ç.Menaxhim; d. Ekonomiks, me kohëzgjatje 4 vite akademike 8 semestra në Bachelor në “Ekonomiks dhe Financë” me profile “Ekonomiks”, “Financë” dhe “Kontabilitet”, me 180 kredite me kohëzgjatje normale 3 vite akademike, 6 semestra në formë studimi me kohë të plotë në gjuhën angleze. Veprimtaria akademike e programit të riorganizuar ka filluar në vitin akademik 2020-2021. Programi ofrohet me kohë të plotë, në gjuhën angleze, në përputhje me nivelin e gjashtë të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Njësia përgjegjëse për zhvillimin dhe monitorimin e këtij program studimi është Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës, e cili është pjesë e Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit.

Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit përbëhet nga:

1. Departamenti i Administrim Biznesit;
2. **Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës;**
3. Departamenti i Informatikës së Biznesit dhe e –Biznesit;

Pedagogë nga Departamenti i Administrim Biznesit dhe Departamenti i Informatikës dhe e-Biznesit kontribuojnë në programin e studimit Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile

“Ekonomiks”, “Financë” dhe “Kontabilitet” në lëndët “Mjedisi Ligjor i Biznesit”, “Të drejtat e njeriut”, “E drejta dhe Politika e Bashkimit Evropian”, “Manaxhimi i marrëdhënieve me Klientin”, “Manaxhim i Shitjeve Operacionale”, “Manaxhim i Burimeve Njerëzore”. Rreth 87% e stafit akademik që jep mësim në këtë program studimi është me kohë të plotë. Riorganizimi i programit të studimit, Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile “Ekonomiks”, “Financë” dhe “Kontabilitet”, është bërë me qëllim plotësimin e kërkesave të tregut të punës në vend me specialistë në fushën e financës, ekonomiksit dhe kontabilitetit, që kanë njohuri të konsoliduara jo vetëm teorike por dhe aftësi përpunuese dhe analizuese shumë të mirë të dhënash.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, 2017”, Universiteti i New York-ut në Tiranë, ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit të programit të studimit Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile “Ekonomiks”, “Financë” dhe “Kontabilitet”, nëpërmjet sistemit AMS të ASCAL. Qëllimi kryesor i procesit të vlerësimit të jashtëm është identifikimi i nivelit të përmbushjes së standardeve shtetërore të cilësisë për arsimin e lartë të përcaktuara me VKM nr. 531, datë 11.09.2018, për programin e studimit bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile “Ekonomiks”, “Financë” dhe “Kontabilitet”. ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Universiteti “New York”, Tiranë për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof. Dr. Dorina Kripa dhe Prof. As. Dr. Elida Liko. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demireli. Vizita në Universitetin New York -ut në Tiranë u realizua në datën 29 dhe 30 Qershor, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara sipas axhendës së vizitës në IAL. Gjatë vizitës, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) zhvilloi takime me: Përgjegjësin e Departamentit dhe Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit, Grupin e vetëvlerësimit, stafin akademik të programit të studimit, stafin e njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, zyrën e Burimeve Njerëzore etj. GVJ zhvilloi gjithashtu intervista me studentët e programit, vizitoi Bibliotekën e Institucionit si dhe vëzhgoi mjediset e institucionit si: auditorë, laboratorë, shërbimet për studentët etj. Gjatë takimeve të realizuara sipas axhendës, u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ekspertët kanë drejtuar pyetjet përkatëse. Pas vizitës në IAL, GVJ hartoi raportin e vlerësimit të jashtëm, bazuar në dokumentacionin në dispozicion nga dosja e vetëvlerësimit, informacioni i depozituar në sistemin e informacionit të ASCAL si dhe në informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin pranë ASCAL.



Universiteti i New York-ut Tiranë, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 11.09.2023, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 118/50 Prot, datë 11.09.2023. Universiteti i NewYork-ut Tiranë përcjell në ASCAL më datë 14.09.2023, me anë të shkresës me Nr.86/2 Prot, datë 12.09.2023 “ Përgjijge për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit”, ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Ekonomiks dhe Financë” me profile “Ekonomiks”, “Financë” dhe “Kontabilitet”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Universiteti i New York-ut në Tiranë (referuar shkurt si “UNYT” në këtë raport vlerësimi), ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare, si dhe janë konform ruajtjes së vlerave kulturore kombëtare. Programi i studimit Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile “Ekonomiks”, “Financë” dhe “Kontabilitet”, i cili ofrohet nga Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës, në Fakultetin e Ekonomisë dhe Biznesit të UNYT, është hartuar dhe implementuar në përputhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nenin 74, te Ligjit Nr. 80/2015 për “Arsimin e Lartë dhe kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, aktet nënligjore, • Statutin e UNYT dhe <p>Programi i studimit Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile “Ekonomiks”, “Financë” dhe “Kontabilitet” është riorganizuar bazuar në Urdhërin nr. 212 datë 03.07.2020, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nga program Bachelor në Administrim Biznesi me profile “Ekonomiks”, “Financë”, “Kontabilitet”, “Manaxhim” dhe “Marketing” (4 vite, 128 ECTS) u bë programi Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile “Ekonomiks”, “Financë” dhe “Kontabilitet” (3 vite, 180 ECTS).</p>

	<p><i>Evidenca 1.1. Statuti i UNYT</i></p> <p><i>Evidenca 1.7. Rregullorja e Universitetit</i></p> <p><i>Evidenca 2.4 Strategjia për Ndërkombëtarizim për Zhvillim dhe Integrim European</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile “Ekonomiks”, “Financë” dhe “Kontabilitet”, i ofruar nga Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit, të UNYT, në përgjegjësi të Departamentit të Ekonomiksit dhe Financës është program i Ciklit të parë të studimeve, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike dhe me një total prej 180 kredite (ECTS). Ky program u liçensua me Urdhërin Nr. 212 datë 03.07.2020 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.</p> <p>Ky program studimi është hartuar dhe ofrohet në përputhje me misionin e UNYT të shprehur në Statutin dhe në Rregulloren e IAL, si dhe në përputhje me fushën e veprimtarisë së tij dhe qëllimit të zhvillimit institucional. GVJ vlerëson se ky program iu ofron studentëve një diplomë universitare, e cila do t’u japë atyre njohuritë, aftësitë akademike dhe praktike, të mjaftueshme për të qenë të aftë për tregun e punës.</p> <p><i>Evidenca 1.1. Statuti i UNYT</i></p> <p><i>Evidenca 1.7. Rregullorja e Universitetit</i></p> <p><i>Evidenca 1.12 Studim tregu</i></p> <p><i>Evidenca 1.7. Rregullorja e Universitetit</i></p> <p><i>Evidenca 1.12 Studim tregu</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile “Ekonomiks”, “Financë” dhe “Kontabilitet” hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së UNYT si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij. Rregulloret, statuti, strategjitë e zhvilluara në vite, kanë nxjerrë në pah misionin dhe objektivat e institucionit, dhe në krye të tyre janë programet e tij të studimit, promovimi i metodave inovative të mësimdhënies dhe të nxënimit me në qendër studentin, inkurajimi i studentëve për aktivitete sociale në të gjithë Unionin Studentor dhe klubet studentore, si dhe vlerësimi i ndërkombëtarizimit si pjesë strategjike e tij.</p> <p>Programi i studimit është hartuar dhe ofruar në koherencë të plotë me objektivat strategjike, misionin dhe vizionin e UNYT. Në vijimësi, mbështetur në “Planin Strategjik 2020-2025”, UNYT garanton dhe respekton lirinë akademike në</p>


	<p>mësimdhënie, në mësimnxënie, në inovacion, dhe në aktivitete krijuese duke synuar nivelet maksimale të cilësisë në fushat e drejtimet akademike të tij. Veçanërisht ky program specifik studimi u ofron studentëve një avantazh në forcimin e karrierës së tyre, vizionin e tyre dhe njohjen e mundësive dhe sfidave globale.</p> <p><i>Evidenca 1.1. Statuti i UNYT</i></p> <p><i>Evidenca 1.6. Plani strategjik 2020-2025</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>GVJ vlerëson se ky program studimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ofrohet nga UNYT i cili ka një eksperiencë shumë produktive në ofrimin e programeve bachelor dhe jo vetëm; • UNYT tregon përpjekjet e vazhdueshme në ofrimin e një infrastrukture shumë të mirë; • Staf i akademik ka përvojë të qëndrueshme pranë kësaj IAL, si dhe ka një përputhje të plotë të fushës së kërkimit të tyre me qëllimin e këtij program studimi. <p>Programi i studimit Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile “Ekonomiks”, “Financë” dhe “Kontabilitet”, është riorganizuar në program bachelor tre vjeçar bazuar në Urdhërin nr. 212 datë 03.07.2020, ofrohet nga Departamenti Ekonomiks dhe Financës, pjesë e Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit, i cili është i organizuar në tre njësi themelore sipas Ligjit për Arsimin e Lartë Nr. 80/2015:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Administrimit të Biznesit, 2. Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës, 3. Departamenti i Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit (i riorganizuar sipas vendimit të Senatit Akademik të UNYT Nr. 62, datë 12.02.2020). <p><i>Evidenca 2.1 Planet Mesimore</i></p> <p><i>Evidenca 2.14 Sylabuset e lëndëve ABF</i></p> <p><i>Evidenca 2.5 Tabelat Përmbledhëse</i></p> <p><i>Evidenca 5: Cv Stafit Akademik i programit të studimit</i></p> <p><i>Dokumenta shtesë nga vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile “Ekonomiks”, “Financë” dhe “Kontabilitet” ofrohet dhe është në përputhje të plotë me fushën specifike të programeve që ofron Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës. Ai ka për qëllim të krijojë paralelisht njohuri shkencore dhe akademike si dhe ato praktike, për ta aftësuar studentin me njohuritë në</p>

<p>kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>industrinë bankare dhe të përgatisë staf të specializuar dhe të kualifikuar. Ky program ofrohet dhe zhvillohet me kohë të plotë dhe duke u bazuar në udhëzimet e direktivave kombëtare dhe Evropiane. Ky program studimi zhvillohet me kohë të plotë, zgjat 3 vite akademike, siguron 180 kredite dhe bazohet në udhëzimet e direktivave kombëtare dhe Evropiane.</p> <p><i>Evidenca 1.2: Vendimi Nr.62, datë 12.02.2020 i Senatit Akademik për hapjen e programit të studimit;</i></p> <p><i>Evidenca 1.6: Plani Strategjik 2020-2025</i></p> <p><i>Evidenca 1.8: Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit</i></p> <p><i>Evidenca 1.9: Rregullore e Departamentit të Ekonomiksit dhe Financës;</i></p> <p><i>Evidenca 1.10: Rregullore e Programit të studimit Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile “Ekonomiks”, “Financë” dhe “Kontabilitet”</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UNYT dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion eksperiencën shumë të mirë të ofrimit të programeve të studimit në përgjithësi, dhe programit Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile “Ekonomiks”, “Financë” dhe “Kontabilitet”, në veçanti. Ky program studimi i përmbush më së miri misionin dhe objektivat e UNYT, të shprehura në të gjitha dokumentat e tij. Ky program studimi ruan interesat dhe vlerat kombëtare.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së</p>	<p>Në funksion të realizimit të programeve të tij të studimit, UNYT ka hartuar strukturën organizative, në të cilën përcaktohet vendosja e detyrave apo aktiviteteve që lejon funksionimin e duhur të çdo departamenti, me synimin e ofrimit dhe sigurimit të cilësisë në kuadër të realizimit të programit të studimit. UNYT ka hartuar rregullore, politika,</p>

detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.

procedura, udhëzues dhe manualë, përmes të cilave mbikqyr mbarëvajtjen e tyre.

Programi i studimit Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile “Ekonomiks”, “Financë” dhe “Kontabilitet” është në drejtimin e Departamentit dhe bashkëpunimit efektiv me Dekanatin dhe Rektoratin, siguron funksionimin normal të njësisë dhe programit. Departamenti si njësi kryesore vendos ngarkesën dhe monitorimin e personelit nëpërmjet instrumentave të sigurimit të cilësisë. Personeli i cili angazhohet në ofrimin e programit të studimit Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile “Ekonomiks”, “Financë” dhe “Kontabilitet” mund t’i përkasë departamenteve të ndryshme.

Në mënyrë periodike, Dekanati dhe Drejtuesi i Departamentit, së bashku me anëtarët e Departamentit organizojnë mbledhje në lidhje me procesin e mësimdhënies dhe kërkimin shkencor. Në këto takime anëtarët e Departamentit përgatisin dhe paraqesin objektivat vjetorë në fillim të vitit akademik. Progresi i tyre në lidhje me këto objektiva vlerësohet dhe pasqyrohet në Raportin Vjetor të përgatitur nga Departamenti në fund të vitit akademik.

Më konkretisht, përgjegjës për koordinimin e njësive bazë është Dekani, si autoriteti menaxhues i Fakultetit. Nëpërmjet strukturës organizative mundësohet vendosja e detyrave apo aktiviteteve që lejon funksionimin e duhur të çdo departamenti, me synimin e ofrimit dhe sigurimit të cilësisë në kuadër të realizimit të programit të studimit. Gjatë vizitës në institucion dhe bazuar në dokumentacionin shoqërues të RVB, GVJ iu konfirmua se Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit, dhe Departamenti Ekonomiks dhe Financë, kryejnë analiza mbi mësimdhënien dhe aktivitetin kërkimor shkencor të personelit akademik. Institucioni përpiqet që të nxisë bashkëpunimin e vazhdueshëm mes njësive dhe personelit akademik në funksion të procesit të mësimdhënies dhe punës kërkimore-shkencore.

Evidenca 1.1. Statuti i UNYT

Evidenca 1.7. Rregullorja e Universitetit

Evidenca 1.8: Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit

Evidenca 1.9: Rregullore e Departamentit të Ekonomiksit dhe Financës;

Evidenca 1.10: Rregullore e Programit të studimit Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile “Ekonomiks”,

	<p><i>“Financë” dhe “Kontabilitet” Evidenca 1.14: Raport vjetor i Departamentit</i></p> <p><i>Shënime gjatë vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>UNYT gjatë dy dekadave ka vendosur një sërë marrëveshjesh dhe bashkëpunimesh kombëtare dhe ndërkombëtare me institucione vendase dhe universitete të tjera vendase dhe të huaja. Një prej bashkëpunimeve kryesore cilësohet ofrimi i mobiliteteve nëpërmjet programeve Erasmus. Theksojmë faktin që UNYT ofron gjatë gjithë eksperiencës së tij programe të suksesshme të zhvilluara në gjuhën angleze. UNYT e konsideron ndërkombëtarizimin si një komponent thelbësor të zhvillimit dhe misionit të tij.</p> <p>Që nga viti 2018, UNYT është pjesë e shkollave ndërkombëtare të rrjetit MAARIF, në 67 shtete të ndryshme, me 340 institucione edukimi (www.ghmaarifschools.org). Gjithashtu procesi i mesimdhënies ofrohet në gjuhën angleze dhe përmes një fondi librash të viteve të fundit po në këtë gjuhë.</p> <p><i>Evidenca 1.11: Marrëveshja e bashkëpunimit me BKT (MoU);</i> <i>Evidenca 1.6: Plani Strategjik 2020-2025</i> <i>Evidenca 1.10: Rregullore e Programit të studimit Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile “Ekonomiks”, “Financë” dhe “Kontabilitet” Raporti i Literaturës</i> <i>Evidenca 5.1: Lista e MOU;</i> <i>Evidenca 5.2: MoU ERSAMUS</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Me qëllim realizimin e praktikës profesionale, si dhe krijimin e mundësive për punësimin potencial të studentëve, UNYT ka nënshkruar 30 marrëveshje bashkëpunimi dhe është në proces të nënshkrimit të marrëveshjeve bashkëpunuese edhe me 21 kompani private, në kuadrin e të gjithë IAL. Nga këto marrëveshje vetëm për Fakultetin e Ekonomisë dhe Biznesit, janë nënshkruar dhjetë marrëveshje dhe janë në proces edhe katër marrëveshje.</p> <p>Pjestarë të institucioneve me të cilat IAL ka nënshkruar memorandum bashkëpunimit, janë të angazhuar në dhënien e leksioneve, si lektorë të ftuar në kuadrin e lëndëve të ndryshme me qëllim ilustrimin e teorisë me raste studimore praktike. Numri i aktiviteteve në nivel Departamenti, për periudhën në analizë për këtë program studimi është 8.</p> <p><i>Evidenca 5.1. Lista e Marrëveshjeve të bashkëpunimit UNYT</i></p>



	<i>Evidenca 2.5. Tabelat përmbledhëse (tabela nr. 5)</i> <i>Evidenca 2.7. Aktivitete të Departamentit</i>			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Programi i studimit Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile “Ekonomiks”, “Financë” dhe “Kontabilitet” është një program i riorganizuar. Prandaj dhe monitorimi i ecurisë dhe suksesit të këtij programi është shumë i përkushtuar nga stafi UNYT. Departamenti në fund të vitit akademik përgatit raportin vjetor të Departamentit i cili i paraqitet Dekanit të Fakultetit. Ky raport ofron një pasqyrë analitike të përmbushjes së objektivave të programit. <i>Evidenca 1.14: Raport vjetor i Departamentit</i> <i>Shënime gjatë vizitës në institucion</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se UNYT ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me IAL brenda dhe jashtë vendit si dhe me institucione publike dhe private. Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës ndjek nga afër ecurinë e studentëve që zhvillojnë praktika profesionale pranë institucioneve publike dhe private dhe konsideron opinionin e punëdhënësve në analiza periodike për përmirësim të mëtejshëm të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë	Programi i studimit Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile “Ekonomiks”, “Financë” dhe “Kontabilitet” është organizuar bazuar në nenin 73, pika 1, e ligjit 80/2015 “Për

<p>strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, me 180 kredite (ECTS) në total me një kohëzgjatje prej 3 vitesh.</p> <p>Bazuar në <i>nenin 3</i>, të Rregullores të programit të studimit, viti akademik është i ndarë në dy semestra, çdo semestër përfshin 15 javë mësimore. Në planin mësimor të programit të studimit, çdo vit akademik është i organizuar në dy semestra me një ngarkesë të barabartë prej 30 ECTS për çdo semestër, ose 60 ECTS në një vit akademik, me një total prej 180 ECTS. Plani mësimor përmban të gjithë veprimatrinë formuese të përcaktuar nga shtojca nr. 1, VKM nr. 41 datë 24.01.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, e ndryshuar me VKM nr. 879 datë 18.12.2019.</p> <p><i>Evidenca 2.1. Plani mësimor i studimit</i></p> <p><i>Evidenca 1.10. Rregullore e programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Në <i>nenin 6</i>, të Rregullores të programit të studimit, janë përcaktuar rezultat e njohurive, pas përfundimit të suksesshëm të programit të studimit. Bazuar në lëndët që përmban programi i studimit, konstatojmë se studentët kanë aftësi të njohin marrëdhëniet ndërmjet variablave të ndryshëm ekonomik dhe të bëjnë prezantimin e tyre në model përmbledhës, bazuar në njohuri të përfituara nga lëndët “Mikroekonomi I”, “Mikroekonomi II”, Ekonomiksi i Sektorit Publik”, “Makroekonomi I” dhe “Makroekonomi II”.</p> <p>Studentët janë të pajisur me njohuri të konsoliduara për përpunimin e të dhënave ekonomike. Kanë aftësi të bëjnë parashikim ekonomik me njohuritë e fituara në lëndë si “Kalkulus I” dhe “Kalkulus II”, “Statistikë I”, dhe “Statistikë II”, “Matematikë për financën” dhe “Ekonometri”. Referuar njohurive të konsoliduara të fituara gjatë kursit, studentët mund të vazhdojnë studimet Master. Anvanzat i programit të studimit, është pajisa e studentëve me njohuri shumë të mira në përpunimin e të dhënave, ndërtimin e parashikimeve për variabla të ndryshëm ekonomik, paraqitjen e modeleve të thjeshta për mënyrën sesi funksionon ekonomia dhe ndërveprimin e ekonomisë me vende të tjera në kuadër të globalizimit.</p> <p><i>Evidenca 2.1. Plani mësimor i studimit</i></p>

Evidenca 1.10. Rregullore e programit të studimit

Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.

Veprimtaria formuese e programit të studimit është e përcaktuar, në përputhje me VKM nr. 41 datë 24.01.2018, të ndryshuar me VKM nr. 879 datë 18.12.2019.

Kategoria	Tipi i komponentit mësimor	Bachelor sipas shtojcës 1, VKM	Ofruar nga programi
A	Lëndë bazë	15% -20% (kredite)	20%
B	Lëndë karakterizuese	50% -55% (kredite)	50%
C	Lëndë ndërdisiplinore/ integruese	12% -15% (kredite)	13.33%
D	Lëndë Plotësuese	10% -15% (kredite)	12.22%
E	Detyrime përmbyllëse	3% -5% (kredite)	4.44%

Bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelë, konstatojmë se veprimtaria formuese e programit është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga ligji.



Evidenca 2.1. Plani mësimor i studimit

Evidenca 1.10. Rregullore e programit të studimit


Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.

Bazuar në *nenin 19*, të Rregullores së Departamentit, praktika profesionale është e detyrueshme dhe regjistrohet si kurs i rregullt. Pa realizimin e praktikës profesionale, studentët nuk mund të mbrojnë diplomën. Kriteret për praktikën janë të përcaktuara në Rregulloren e praktikës. Për programin e studimit të ciklit të parë, studenti që merr minimalisht 144 kredite ECTS, konsiderohet të jetë në dispozicion diplomimi. Studentët që kanë mbetur në kurset e ofruara në vitin e parë të studimit, nuk mund të regjistrohen në projektin e diplomimit. Në planin e studimit, “Praktika profesionale”, është në kategorinë e lëndëve plotësuese, është vlerësuar me 4 kredite ECTS, ndërsa projekti i diplomimit, si detyrim përmbyllës është vlerësuar me 8 kredite ECTS.

	<p><i>Evidenca 2.1. Plani mësimor i studimit</i></p> <p><i>Evidenca 1.9. Rregullore e departamentit</i></p> <p><i>Evidenca 3.3. Rregullore e projektit të diplomimit</i></p> <p><i>Evidenca 3.3.1. Manual për projekt diplomimi</i></p>																					
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Procedura e pranimit dhe e regjistrimit të studentëve është e përcaktuar në <i>nenet 7 -14</i> të Rregullores të programit të studimit. Kuota e studentëve për programin e studimit propozohet nga Departamenti dhe miratohet me vendim Senati. Pranimi i studentëve është në përputhje me pikën 1, nenin 74 të ligjit 80/ 2015. Pranohen kandidatët që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm, që plotësojnë kriterin e notës mesatare dhe janë shpallur fitues nga Departamenti. Aplikimet bëhen me anë të portalit U -Albania. Studentët e huaj janë të detyruar të ndjekin procedurën e njohjes dhe ekuivalentimit të diplomës. Ndjekja e procedurave për pranimin e studentëve të huaj, bëhet nga Senati. Kriteri i notës mesatare, është i vlefshëm edhe për studentët e huaj, pas njohjes së diplomës. Programi i studimit ofrohet në gjuhën angleze, si rrjedhim studentët që aplikojnë për këtë program studimi, duhet të kenë të paktën nivelin B1 të gjuhës angleze.</p> <p><i>Evidenca 1.10. Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>Evidenca 5.3. -5.3.2 Kuotat e regjistrimit</i></p>																					
<p>Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Kriteri ligjor i përcaktuar në pikën 2, neni 86, ligji 80/2015, plotësohet. Bazuar në planin mësimor të programit të studimit “Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile “Ekonomiks”, “Financë” dhe “Kontabilitet”, konstatohet se kanë përmbajtje të ngjashme në masën 70%.</p> <p>Lëndë karakterizuese si përgatitje specifike për disiplinën janë 9 (nëntë) në perofilet “Ekonomiks” dhe “Kontabilitet” dhe 8(tetë) për profilin “Financë” nga 30 të ofruara gjatë tre viteve të studimit, sipas tabelës së mëposhtme:</p> <table border="1" data-bbox="550 1534 1340 1948"> <thead> <tr> <th>Profili Ekonomiks</th> <th>Profili kontabilitet</th> <th>Profili financë</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>- Kalkulus II</td> <td>- Drejtim financiar</td> <td>-Drejtim financiar</td> </tr> <tr> <td>- Ekonometri</td> <td>- Kontabilitet I</td> <td>- Analizë e raporteve financiare</td> </tr> <tr> <td>- Mikroekonomi II</td> <td>- Kontabilitet II</td> <td>- Tregje dhe institucione financiare</td> </tr> <tr> <td>- Makroekonomi II</td> <td>- Auditim</td> <td></td> </tr> <tr> <td>- Ekonomiks industrial</td> <td>- Kontabilitet Kosto</td> <td></td> </tr> <tr> <td></td> <td>- Analizë e raporteve financiare</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Profili Ekonomiks	Profili kontabilitet	Profili financë	- Kalkulus II	- Drejtim financiar	-Drejtim financiar	- Ekonometri	- Kontabilitet I	- Analizë e raporteve financiare	- Mikroekonomi II	- Kontabilitet II	- Tregje dhe institucione financiare	- Makroekonomi II	- Auditim		- Ekonomiks industrial	- Kontabilitet Kosto			- Analizë e raporteve financiare	
Profili Ekonomiks	Profili kontabilitet	Profili financë																				
- Kalkulus II	- Drejtim financiar	-Drejtim financiar																				
- Ekonometri	- Kontabilitet I	- Analizë e raporteve financiare																				
- Mikroekonomi II	- Kontabilitet II	- Tregje dhe institucione financiare																				
- Makroekonomi II	- Auditim																					
- Ekonomiks industrial	- Kontabilitet Kosto																					
	- Analizë e raporteve financiare																					

	<ul style="list-style-type: none"> - Ekonomiks i sektorit publik - Ekonomiks ndërkombëtar - Ekonomia e BE - Zhvillimi social ekonomik 	<ul style="list-style-type: none"> - Taksimi teori, praktikë - Kontabilitet i avancuar - Mjedisi ligjor i biznesit 	<ul style="list-style-type: none"> - Financë ndërkombëtare - Menaxhim investimesh - Financë e aplikuar korporatash - Derivate dhe instrumenta financiare - Ekonometri
<i>Evidenca 2.1. Plani mësimor i studimit</i>			
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe vizitën në institucion, konstatojmë se të gjitha lëndët e ofruara në programin e studimit, janë të koduara sipas dispozitave të pikës 1, neni 86 të ligjit 80/2015, si dhe Udhëzimin me nr. 31, datë 15.01.2022, për “Procedurat për Kodifikimin e Programeve të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë.”</p>		
<i>Evidenca 1.3. UNYT kodimet</i>			
<p>Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit nuk ofrohet në bashkëpunim me asnjë institucion tjetër të arsimit të lartë. Programi i studimit është riorganizuar në vitin akademik 2020-2021, por stafi akademik është i qendrueshëm, ka eksperiencën e bashkëpunimit me Universitetin Shtetëror të New York/ Empire State College për programin Bachelor 4 vjeçar të tipit amerikan me 256 ECTS. Pas riorganizimit programi ka ruajtur mësimdhënien në gjuhën angleze.</p>		
<i>Evidenca 1.10. Rregullore e programit të studimit</i>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit është riorganizuar si pasojë e zhvillimeve të tregut të punës në vend në përputhje me dispozitat e ligjit 80/2015 dhe të akteve të tjera ligjore. Eksperianca a fituar në mësimdhënie nga bashkëpunimi i mëparshëm me Universitetin Shtetëror të New York/ Empire State College reflektohet në programin aktual të studimit. Stafi akademik është i qendrueshëm. Mësimdhënia vazhdon të jetë në gjuhën angleze.</i></p> <p><i>Studentët përfitojnë njohuri të avancuara analitike, duke u bërë më konkurrues në tregun e punës.</i></p>		

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Universiteti i New York-ut në Tiranë, ka marrë akreditimin institucional me Vendim Nr. 61, datë 18.12.2020 të Bordit të Akreditimit, me kohëzgjatje 6 vite akademike. Afati i vlefshmërisë së akreditimit institucional përfundon në 17.12.2026.</p> <p>Programi i studimit, Bachelor në Ekonomiks dhe Financë, me profilet “Ekonomiks”, “Financë” dhe “Kontabilitet”, ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit, Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës. Bazuar në nenin 23, të ligji 80/2015, Fakulteti është njësi kryesore që bashkërendon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fusha të përafërta, organizohet nga të paktën tri njësi bazë, së paku dy prej të cilave janë departamente. Ky kriter ligjor plotësohet. Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit përbëhet nga tre departamente:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Adnistrim Biznesit; 2. Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës; 3. Departamenti i Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit; <p>Bazuar në nenin 10 të statutit, Fakulteti është njësia kryesore që koordinon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor. Bazuar në nenin 25 të ligjit 80/2015, Departamenti është njësia bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore shkencore të Fakultetit, ka në përbërjen e tij të paktën shtatë anëtarë të punësuar me kohë të plotë, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore. Konstatohet se ky kriter ligjor plotësohet. Bazuar në nenin 11, të Statutit dhe në nenin 2 të Rregullores së Departamentit, Departamenti është njësia bazë për mësimdhënien, si e tillë vlerësohet në mënyrë periodike. Bazuar në nenin 12 të Statutit, dhe në nenin 3 të Rregullores së Departamentit, Departamenti përbëhet nga të paktën 7 anëtarë, me kohë të plotë, nga të cilët tre mbajnë grada shkencore.</p> <p>Stafi akademik i Departamentit të Ekonomiksit dhe Financës, referuar dokumentit (<i>tabela përmbledhëse nr. 1</i>)</p>

Titull/grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr	-	-	-	-	-	-
Prof. Asoc.	1	1	2	1	2	1
Dr.	3	1	2	3	2	2
MSc	3	1	3	1	4	2
Totali	7	3	7	5	8	5
	10		12		13	

Konstatohet se Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës, ka pak pedagogë me kohë të plotë që i përkasin kategorisë “Profesor”, por kriteri ligjor plotësohet.

Evidenca 1.1. UNYT Statuti

Evidenca 1.9. Rregullore e Departamentit të Ekonomiksit dhe Financës

Evidenca 2.5. Tabelë përmbledhëse

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.

Kapitulli 7, i Statutit, përshkruan detyrat e njësive administrative dhe stafit ndihmës akademik. Zyra e çështjeve studentore, realizon një komunikim të vazhdueshëm me studentët e të gjitha niveleve. Zyra e mbështetjes në teknologji dhe informacion, mbështet për të gjitha çështjet që lidhen me këtë sektor. Në nenin 22, të Rregullores të programit të studimit është përcaktuar se aktivitetet mësimore praktike dhe laboratorike, kanë një kohëzgjatje 10-12 orë gjatë një semestri. Shkrimi akademik organizohet si një veprimtari e detyrueshme praktike dhe laboratorike e mësimdhënies. Çdo student merr të paktën 2 veprimtari praktike dhe laboratorike gjatë gjithë programit. Bazuar në tabelën përmbledhëse 2, konstatohet se, në programin Bachelor në Ekonomik dhe Financë me profil “Ekonomik”, “Financë” dhe “Kontabilitet”, janë angazhuar si personel ndihmës akademik, 16 anëtarë për vitin akademik 2020-2021, 18 anëtarë për vitin akademik 2021-2022 dhe, 9 anëtarë për vitin akademik 2022-2023.

Nga vizita në institucion, konstatojmë se lëndë të tilla si “Statistika I”, “Statistika II” dhe “Ekonometria”, zhvillohen në laborator, ku gjatë shpjegimit studentët kanë mundësi me anë të programeve të tilla si STATA, të konkretizojnë shembuj. Laboratori përdoret gjithashtu dhe për realizimin e detyrave në këto lëndë. Kjo metodë mësimdhënie, sjell avantazh, pasi gërshetohet njëkohësisht teoria me praktikën.

	<p><i>Evidenca 1.1. Statuti UNYT</i></p> <p><i>Evidenca 1.10. Rregullorja e programit të studimit</i></p> <p><i>Evidenca 2.5. Tabelë përmbledhëse</i></p>			
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Përgjegjësi i Departamentit, bazuar në funksionet dhe përgjegjësitë në përputhje pikën 5, neni 24 i Statutit të UNYT, është përgjegjës për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor dhe aktivitete të tjera ndër universitare duke siguruar arritjen e objektivave dhe cilësinë. Bazuar në <i>gërmën b, neni 16, i Rregullores të Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit</i>, si dhe në <i>nenin 18, të Rregullores të programit të studimit</i>, Përgjegjësi i Departamentit cakton një këshilltar akademik për secilin student. Detyra e këshilltarit akademik është të ndjek punën akademike dhe të udhëzojë studentët në të gjitha çështjet arsimore.</p> <p><i>Evidenca 1.1. Statuti i UNYT</i></p> <p><i>Evidenca 1.8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit</i></p> <p><i>Evidenca 1.10. Rregullore e programit të studimit</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kriteret ligjore, ka në përbërje të saj 7 pedagogë me kohë të plotë nga të cilët 3 mbajnë grada shkencore. Konstatuam se pedagogë të brendshëm të kategorisë profesor ishte vetëm 1 (një) për vitin akademik 2020-2021, dhe 2 (dy) për vitet 2021-2022 dhe 2022 -2023. Ky fakt është kompensuar deri diku nga përfshirja e një pedagogu të jashtëm i kategorisë profesor.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.



Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve


Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme

Bazuar në *nenin 11, të Statutit të UNYT*, Departamenti është njësia bazë përgjegjëse për mësimdhënien dhe për vlerësimin periodik. Bazuar në *nenin 24 të Statutit dhe në nenin 5 të Rregullores të Departamentit, Drejtuesi i Departamentit*



<p>për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>menaxhon njësinë bazë dhe është anëtar i Këshillit të Fakultetit. Ndër detyrat e specifikuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përgatitja e programeve dhe shpërndarja e ngarkesës mësimore; - mbikqyrja e aktiviteteve të mësimdhënies dhe kërkimit; - promovimi i praktikave më të mira të mësimdhënies; - vlerësimi periodik i stafit; <p>Në pjesën C, të Rregullores të Departamentit, është përcaktuar mënyra e organizimit të procesit mësimor, llojet e kurseve, kreditet, praktikat dhe projekti i diplomimit. Programi i studimit, Bachelor në Ekonomiks dhe Financë, është i organizuar në përputhje me objektivat e programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 1.1. Statuti i UNYT</i></p> <p><i>Evidenca 1.8. Rregullore e Departamentit</i></p> <p><i>Evidenca 1.10. Rregullore e programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Në Rregulloren e programit të studimit, është përcaktuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - viti akademik i ndarë në dy semestra me 15 janë mësimore; - gjuha zyrtare e mësimdhënies, është gjuha angleze; - numri 30 ECTS i krediteve për semestër (60 ECTS për vit akademik); - Numri total i krediteve 180 ECTS për programin e studimit; <p>Në planin mësimor, është e përcaktuar, për secilin nga profilet e bachelorit në Ekonomiks, Financë dhe Kontabilitet, lëndët të ndara në semestra, vite akademike, duke specifikuar kategorinë, kreditet, numrin e provimeve, ndarja e orëve në semestër, totali i orëve në auditor, totali i orëve jashtë auditorit. Në përshkrimin e programit të studimit për secilin nga profilet, janë përcaktuar, kategoritë e lëndës, kreditet, kushtet paraprake për të ndjekur një kurs të caktuar. Janë të përcaktuara lëndët me zgjedhje që mund të ndiqen dhe kreditet. Në përshkrimin e programit jepen dhe rekomandime për ndjekjen e kurseve të caktuara. Duke ruajtur praktikat më të mira dhe pas riorganizimit të programit të studimit, janë ruajtur kushtet që duhet të plotësohen nga studentët me qëllim regjistrimin në një kurs. Për shembull studenti nuk mund të regjistrohet në “Statistikë II”, pa marrë provimin “Statistikë I”. Nuk mund të regjistrohesh në “Financë të Avancuar” pa marrë provimin “Financë Korporate”</p>

	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, konstatojmë se të gjithë orët e leksioneve, mbuloohen nga pedagogë me tituj akademik. Asnjë staf akademik MSc. nuk është anagazhuar në dhënie të leksioneve. Sfafi akademik është i angazhuar në mësimdhënie përgjithësisht deri në 3 lëndë dhe ka një ngarkesë vjetore në përputhje me dispozitat ligjore.</p> <p><i>Evidenca 1.10. Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>Evidenca 2.1. Prani mësimit</i></p> <p><i>Evidenca 2.3. Përshkrimi i programit</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Konstojmë se, pranimi i studentëve të rinj është në përputhje me nenin 74, të ligjit 80/2015. Departamenti përzgjedh studentët fitues, të cilët miratohen nga Drejtuesi i njësisë kryesore. Në pjesën B, të Rregullores të programit të studimit është përcaktuar procedura e pranimit të studentëve:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pranimi në ciklin Bachelor, kërkon përfundim të arsimit të mesëm, plotësim të kriterit të notës mesatare, në përputhje me VKM 295, datë 10.05.2019; - Studentët e huaj duhet të ndjekin procedurën e njohjes së diplomës dhe ekuivalentimit. Procedurat për studentët e huaj ndiqen nga senati. Kriteri i notës mesatare është i vlefshëm për studentët e huaj, pas njohjes së diplomës; - Në afatet e përcaktuara nga ministria, studentët duhet të bëjnë kërkesë në Zyrën e çështjeve studentore; - Pranimi për studentët e transferuar është në përputhje me ligjin 80/2015. Kërkesa për transferimin e krediteve shqyrtohet nga një komision ad-hoc dhe aprovohen nga dekani. Studentët e transferuar që të diplomohen duhet që të fitojnë të paktën gjysmën e krediteve në UNYT; <p>Konstatojmë se kriteri ligjor i përcaktuar nga pika 2.1, gërma ç, VKM 41, datë 24.01.2018, plotësohet. Në përputhje me VKM për programet e ciklit të parë numri maksimal i krediteve të njohura është 60 kredite.</p> <p>Universiteti lejon shkëmbim të studentëve për një nga programet e shkëmbimit që oftuara në UNYT (Erasmus+, Mevlana, ose marrëveshje bilaterale), duke i dhënë statusin e studentit të shkëmbyer. Kriter shtesë për regjistrim në këtë program studimi, është çertifikata e gjuhës angleze, niveli B1, nga TOEFL, IELTS, APTIS dhe çdo provim tjetër që parashikohet nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve. Të gjithë studentët duhet që të kalojnë provimin e gjuhës angleze, përfshi</p>

	<p>studentët e transferuar dhe të shkëmbyer. Studentët kanë mundësi regjistrimi “i kufizuar”, kur nuk kanë një certifikatë të vërtetimit të njohurive të gjuhës angleze, me kusht që të sigurohet certifikata deri në fund të vitit të parë akademik. Në rregullore janë të përcaktuara dokumentat e kërkuara për rregjistrim për herë të parë. Studentët e regjistruar për herë të parë, pas pagesës së shkollimit, aplikojnë në Zyrën e Regjistrimeve dhe marrin numrin dhe Kartën e studentit.</p> <p><i>Evidenca 1.10. Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>Evidenca 5.3. Kuotat për vit akademik</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Në planin mësimor, për secilën lëndë, është dhënë kategoria e lëndës, kreditet, ndarja e orëve në një semestër, në leksione, seminare/ ushtrime, detyrë/ projekte dhe studim individual. Totali i orëve në auditor dhe totali i orëve jashtë auditorit. Është përcaktuar, praktika mësimore dhe projekti i diplomimit.</p> <p>Në syllabusin e secilës lëndë janë përcaktuar orët e aktiviteteve mësimore: leksione, ushtrime, seminar, punë në grup, projekte, detyra shtëpie, si dhe orët e studimit individual.</p> <p><i>Në pjesën më të madhe të syllabuseve të lëndëve, komponentë të tjerë, si pjesë e vlerësimeve të vazhdueshme gjatë vitit <u>nuk janë specifikuar.</u></i></p> <p><i>Konstatohet se orët e laboratorit nuk janë të specifikuar në <u>syllabus</u>, për asnjë nga lëndët. Nga vizita në institucion, konstatohet se, lëndët që kanë nevojë për laboratore dhe aplikojnë programe të caktuara të shkencave sociale, zhvillohen në laborator.</i></p> <p><i>Evidenca 2.1. Plani mësimor</i></p> <p><i>Evidenca 2.14. Syllabuset</i></p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Konstatohet se, programi është riorganizuar jo vetëm duke ndryshuar emërtimin nga Diplomë e nivelit të parë (DNP) në Administrim Biznesi me profile Ekonomiks, Financë, Kontabilitet, Menaxhim dhe Marketing në Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile Ekonomiks, Financë dhe Kontabilitet, që realizon 180 kredite evropiane dhe me kohëzgjatje 3 vite akademike, por programi i riorganizuar nuk ofron më profilet Menaxhim dhe Marketing.</p> <p>Ndryshimi ka ardhur si pasojë e kërkesës të tregut të punës. Analiza është bazuar në pyetësorë, si dhe studime për tregut e punës në vend dhe në rajon. Programi i ofruar ndërton njohuri konkurruese në nivel mikro dhe makro, teknika të financimit të</p>

	<p>bizneseve, teknika të kontabilitetit dhe raportimit financiar. Ndryshimi është aplikuar në fillim të vitit akademik 2020-2021. Ky është akreditimi i parë për Bachelorin 3 vjeçar, si rrjedhim priten sygjerimet nga akreditimi, për përmirësime të mëtejshme të programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 2.3. Përshkrimi i programit</i> <i>Evidenca 3.15. & 3.15.1. Propozim për rishikim kurrikule</i> <i>Evidenca 3.15.2. Analizë pyetësorësh Alumni</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Programi është i detajuar dhe për të tre profilet është strukturuar në funksion të objektivave të programit të studimit. Orë laboratorit të përcaktuara në syllabus nuk ka për këtë program studimi. Në pjesën më të madhe të syllabuseve të lëndëve, komponentë të tjerë, si pjesë e vlerësimeve të vazhdueshme gjatë vitit nuk është specifikuar.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


<p>Standardi II.4</p> <p>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxëniet dhe vazhdimet të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Në lëndët e ofruara në programin e studimit, konstatojmë se përmbushen objektivat e programit. Profili “Ekonomiks”, mundëson njohjen e variablave kryesorë ekonomike, lidhjen midis tyre, mundëson realizimin e analizës së të dhënave dhe ndërtimin e modeleve të thjeshta ekonomike. Profili “Financë” dhe “Kontabilitet”, mundëson analizën e pasqyrave financiare, mbajtjen e kontabilitet nga firmat e biznesit, si dhe krijon mundësi për modelime të thjeshta financiare, matjen e riskut etj. Me njohuritë e përfituara në programin Bachelor në të tre profilet, studentët mund të vazhdojnë studime të mëtejshme master, ose mund të futen në tregun e punës.</p> <p><i>Evidenca 1.10. Rregullore e programit</i> <i>Evidenca 2.1. Plani mësimor</i></p>

<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënësit.</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit, konstatohet se programi i studimit është i shpërndarë në tre vite akademike, me dy semestra secili vit, me një ngarkesë totale 180 ECTS, ku në çdo vit akademik dhe semestër ka një shpërndaje të barabartë të krediteve. Kjo është specifikuar dhe në <i>nenin 9</i> të Rregullores së Fakultetit dhe <i>nenin 6</i> të Rregullores së Departamentit.</p> <p>Bazuar në <i>nenin 18</i>, të Rregullores së Departamentit është e mundur ofrimi i kurseve verore, me kushtin që më shumë se 20 studentë aplikojnë për kurs, por është e hapur mundësia e miratimit nga Këshilli i Fakultetit dhe Rektorati, në rastet kur ka më pak aplikantë. Për pozicionin e diplomimit kursi ofrohet dhe nëse kërkohet nga më pak se 5 studentë. Nga shqyrtimi i objektivave të programit të studimit të pasqyruara në <i>nenin 6</i>, të Rregullores të programit të studimit dhe, syllabusit e lëndeve konstatohet se programi mundëson arritjen e objektivave. Studentët e profilit “Ekonomiks”, zhvillojnë aftësi dhe kompetanca në lidhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - modelet makroekonomike dhe mënyrën si funksion ekonomia në afatshkurtër dhe afatgjatë; - lidhjet midis variablave të ndryshëm ekonomik; - përfitimet e një vendi nga tregtia e lirë e mallrave dhe shërbimeve; - rolin e politikës monetare dhe fiskale në kushte të globalizimit; - përdorimin e programeve kopjuterike për analiza të thjeshta; <p>Studentët e profilit “Financë”, zhvillojnë aftësi dhe kompetenca që lidhen me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vendmarrjen financiare të firmës; - marrëdhënien me institucionet financiare; - realizimin e analizave të thjeshta rreth risku –kthimi; - aplikime matematikore për zgjidhjen e probleme praktike të biznesit; <p>Studentët e profilit “Kontabilitet”, zhvillojnë aftësi dhe kompetenca që lidhen me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - mbajtjen e kontabilitetit të firmës të biznesit; - auditimin; - analizën e pasqyrave financiare;
---	--




	<p><i>Evidenca 1.8. Rregullore e Fakultetit</i></p> <p><i>Evidenca 1.9. Rregullorja e Departamentit</i></p> <p><i>Evidenca 1.10. Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>Evidenca 2.14. Syllabuset</i></p>																																				
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Ekonomiks dhe Financë, është i organizuar në orë leksioni dhe sem/ushtrime sipas strukturës më poshtë:</p> <p><u>Profili Ekonomiks</u></p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Orë</th> <th>V.I</th> <th>V.II</th> <th>V.III</th> <th>Totali</th> <th>%</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Leksione</td> <td>300</td> <td>300</td> <td>280</td> <td>860</td> <td>61.4%</td> </tr> <tr> <td>Sem/Ushtime</td> <td>150</td> <td>150</td> <td>240</td> <td>540</td> <td>38.6%</td> </tr> </tbody> </table> <p><u>Profili Kontabilitet & Profili Financë</u></p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Orë</th> <th>V.I</th> <th>V.II</th> <th>V.III</th> <th>Totali</th> <th>%</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Leksione</td> <td>300</td> <td>280</td> <td>280</td> <td>860</td> <td>62.8%</td> </tr> <tr> <td>Sem/Ushtime</td> <td>135</td> <td>150</td> <td>225</td> <td>510</td> <td>37.2%</td> </tr> </tbody> </table> <p>Konstatohet se orët e leksioneve zënë një peshë më të madhe se orët praktike seminar/ ushtime në të tre profilet. Profili “Ekonomiks”, 61.4% orë leksioni dhe 38.6% orë praktike. Profili “Financë” dhe profili “Kontabilitet”, 62.8% orë leksione dhe 37.2% orë praktike.</p> <p><i>Rekomandohet rritjen e orëve praktike në krahasim me ato teorike në syllabus.</i></p> <p><i>Evidenca 2.14. Syllabuset</i></p> <p><i>Evidenca 2.1. Plani mësimorVKM</i></p>	Orë	V.I	V.II	V.III	Totali	%	Leksione	300	300	280	860	61.4%	Sem/Ushtime	150	150	240	540	38.6%	Orë	V.I	V.II	V.III	Totali	%	Leksione	300	280	280	860	62.8%	Sem/Ushtime	135	150	225	510	37.2%
Orë	V.I	V.II	V.III	Totali	%																																
Leksione	300	300	280	860	61.4%																																
Sem/Ushtime	150	150	240	540	38.6%																																
Orë	V.I	V.II	V.III	Totali	%																																
Leksione	300	280	280	860	62.8%																																
Sem/Ushtime	135	150	225	510	37.2%																																
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Veprimtaria formuese e programit të studimit, është në përputhje me tabelën 1, shtojca 1, e VKM nr. 41 datë 24.01.2018, e ndryshuar. Konstatohet se, objektivat e përcaktuara në nenin 6, të Rregullores të programit të studimit, mundësohen nga lëndët e ofruara. Studentët mund të konkurojnë në tregun e punës kombëtar dhe më gjërë, ata përfitojnë njohuri teorike dhe praktike në bachelor, që ju krijon atyre mundësi për të vazhduar studimet e ciklit të dytë.</p> <p>Në të tre profilet e programit, në vitin e dytë, semetri i dytë është përcaktuar praktika/ “intership”, si lëndë më vete, e cila</p>																																				

	<p>vlerësohet 4 ECTS, dhe ka të programuar 10 orë leksioni dhe 90 orë detyra/projekte.</p> <p><i>Konstatohet si pozitiv, faktin që praktika është programuar në vitin e dytë të studimit dhe jo në fund të vitit të tretë.</i></p> <p>Nga dokumentacioni i paraqitur, konstatohet se institucionet dhe kompanitë me të cilat bashkëpunohet për praktikën, janë të mjaftueshme për studentët e kursit, për të vënë në zbatim njohuritë e përfituara në auditor. UNYT ka memorandume bashkëpunimi me 30 institucione, dhe bashkëpunon me 21 ndërmarrje dhe institucione me të cilat është në proces nënshkrimi të memorandumit. Praktika, i vë në kontakt studentët me kërkesat e punëdhënësve, për aftësi dhe kompetenca të caktuara, krijon mundësi për ballafaqimin e njohurive të përfituara në auditor me kërkesat e tregut të punës, mundëson krijimin e kontakteve për mundësi punësimi në të ardhmen.</p> <p><i>Evidenca 1.10. Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>Evidenca 2.1. Plani mësimor</i></p> <p><i>Evidenca 2.14. Syllabuset</i></p> <p><i>Evidenca 5.1. Lista e institucioneve që kanë memorandume bashkëpunimi</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Konstatohet se përditësimi i syllabusit, është pjesë e raportit vjetor të punës të Departamenti të Ekonomiksit dhe Financës, për programin e studimit bachelor me profil ekonomik, financë dhe kontabilitet. Departamenti promovon përdorimin e teknologjisë për të përmirësuar mësimdhënien, rritjen e përdorimit të platformave “Mc -Graw Hill connect”, platformave statistikore dhe ekonometrike.</p> <p><i>Nga rishikimi i syllabuseve konstatohet se, janë bërë investime për blerjen e botimeve të fundit, nga Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit për dhjetë lëndë që ofrohen nga ky program. Grupi i lëndëve që përdorin literaturë të para 10 viteve është i konsiderueshëm.</i></p> <p><i>Nga vizita në institucion, takimi me pedagogët, konstatohet se ata përdorin materiale shtesë mësimore, psh., raste studimore nga vendi, me qëllim pasurimin e lëndës. <u>Rekomandojmë që këto materiale të pasqyrohen në syllabus.</u></i></p> <p><i>Evidenca 1.13. Objektivat e Departamentit</i></p>

	<p><i>Evidenca 2.14. Syllabuset</i></p> <p><i>Evidenca 4.1. Raporti i literaturës</i></p>			
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësi dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Nga rishikimi i syllabuseve dhe planit mësimor, konstatohet se kurset e ofruara i pajisin studentët me aftësi dhe kompetenca në përputhje me kërkesat e tregut të punës në vend. Fakti që mësimdhënia është në gjuhën angleze, rritë mundësitë e studentëve për të punuar pranë kompanive të huaja që punojnë në vendin tonë, duke i bërë më konkurrues në tregun e punës.</p> <p><i>Evidenca 2.14. Syllabuset</i></p> <p><i>Evidenca 2.1. Plani mësimor</i></p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatohet se programi i studimit është riorganizuar në vitin 2020, në përputhje me nevojat e tregut të punës në vend, për t'u përshtatur kërkesave të reja në përputhje me zhvillimin e vendit, bazuar në studime të tregut të punës. Nga Diplomë e nivelit të parë (DNP) në "Administrim biznesi" me profil "Marketing", "Ekonomiks", "Menaxhim", "Financë" dhe "Kontabilitet" me kohëzgjatje 4 vite akademike (8 semestra), në Bachelor në "Ekonomiks dhe Financë" me profile "Ekonomiks", "Financë" dhe "Kontabilitet" me 180 kredite dhe kohëzgjatje normale 3 vite akademike (6 semestra), në gjuhën angleze. Riorganizimi ka hyrë në fuqi në vitin akademik 2020-2021.</p> <p>Të gjithë objektivat e vendosura në nenin 6, të Rregullores të programit të studimit, për aftësitë dhe kompetencat e studentëve të fituara gjatë Bachelorit, përmbushen nga lëndët që ofrohen nga kursi. Studentët me njohuritë e përfitura janë konkurrues në tregun e punës në vend, kanë baza të forta për vazhdimin e studimeve master.</p> <p><i>Evidenca 1.4. Urdhër riorganizimi i programit të studimit</i></p> <p><i>Evidenca 1.10. Rregullore e programit të studimit</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><u>Rekomandojmë</u> që raporti teori praktikë të rishikohet për të tre profilet, duke rritur peshën e orëve praktike në syllabus.</p> <p>Të reflektohen në syllabuset e lëndëve, materialet shtesë, rastet studimore të kohëve të fundit, që nga vizita në institucion konstatuam se zhvilloheshin.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Standardi II.5

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al


Web site: www.ascal.al

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Për çdo vit akademik, bëhet analiza e punës të Departamentit, dhe në bazë të analizës përcaktohen pikat e dobëta dhe mundësitë për përmirësim të vazhdueshëm të programit të studimit. Për çdo vit akademik vendosen objektiva për rishikim të kurseve të ofruara, ofrimin e lëndeve të reja si për shembull “Financë dhe bankë e aplikuar”, në bashkëpunim me bankën e nivelit të dytë BKT, për krijimin jo vetëm të mundësive për praktika të studentëve, por dhe të rritjen e mundësive të punësimit.</p> <p>Departamenti ofron aktivitete ekstra kurrikulare me lektorë të ftuar nga kompani dhe institucione, me qëllim që të përfshijë studentët në diskutime për probleme reale dhe të rritë mundësitë për krijimin e kontakteve me tregun e punës. Si për shembull “Ndikimi i pandemisë Covid -19 në sistemin financiar Shqiptar”, “Menaxhimi i mashtimit financiar”. Universiteti konsideron mendimin e të diplomuarave me anë të pyetësorëve, me qëllim që të mbështesë ndryshimet në programin e studimit. Në këto pyesorë kërkohet mendim në lidhje me kurset që kanë qenë më të vlefshme për ata për tregun e punës ose për të vazhduar studimet master, kërkohet mendim nëse ata do të dëshironin që të zhvillonin ndonjë kurs tjerër.</p> <p><i>Evidenca 1.13. Objektivat e Departamentit të Ekonomisë dhe Financës</i></p> <p><i>Evidenca 2.7. Aktivitete të Departamentit</i></p> <p><i>Evidenca 3.15.3. Pyetësorë për alumni</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Studentët janë të përfshirë në vendim marrje, madje janë një pjesë e rëndësishme e saj. Një nga detyrat e përcaktuara në Rregulloren e Dekanit të Studentëve është përfshirja e studentëve. Studentët e programit të studimit janë përfshirë në konkurse ndërkombëtare (ALSE), që synojnë që të rrisin njohuritë e tyre të investimeve, aftësitë analitike, duke luajtur në bursë. Për çdo vit akademik dhe semestër, hartohen pyetësorë për studentë, me qëllim që të merret mendimi i tyre, për përmirësim të mëtejshëm të kursit. Studentët japin mendimin e tyre për metodat e mësimdhënies, materialet e mësimdhënies, mënyrën e vlerësimit etj.</p>




	<p>UNYT ka krijuar mekanizma për të marrë mendimin e studentëve me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të programit. Studentët mund të shprehin mendimin e tyre përmes Asamblesë të Studentëve, Dekanit të Studentëve, vlerësimit të studentëve, peticioneve, studentët kanë akses direkt tek Drejtuesi i Departamentit, Dekani dhe Rektori për çështjet e mësimdhënies. Një studentët përfaqësues është pjesë e mbledhjeve të Senatit, një student është pjesë e Komitetit për Sigurimin e Cilësisë dhe një student është pjesë e Komitetit të Etikës. UNYT ka ngritur Qendën e Këshillimit të Studentëve, e cila mund të ngrej problematika për probleme akademike, si për shembull mënyrën e vlerësimit, bursat etj.</p> <p><i>Evidenca 2.6. Rregullorja e Dekanit të Studentëve</i> <i>Evidenca 2.7. Aktivitete në Departament</i> <i>Evidenca 3.15.4. Pyetësorë për studentët</i> <i>Evidenca 1.18. Raporti vjetor i Departamentit</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës, organizon aktivitete me lektorë të ftuar, me qëllim gërshtimin e kërkimit shkencor me materialet e ofruara nga kursi. Për shembull:</p> <p>“Ndikimi i pandemisë Covid -19 në sistemin financiar Shqiptar”;</p> <p>“Menaxhimi i vjedhjes”, aktivitet i organizuar për studentët e financës dhe kontabilitetit në kuadër të lëndës së “Auditimit”;</p> <p>“Auditimi i brendshëm”;</p> <p>“Sfidat dhe mundësitë: bota e investimeve”;</p> <p>UNYT ka organizuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Konferencën e parë Ndërkombëtare online “Pasiguritë dhe Sfidat në Ballkan: Rasti i Covid -19”, në vitin 2020; - Konferencën e dytë Ndërkombëtareë online “Ndryshimi dhe transformimi përmes inovacionit dhe kreativitetit”; <p>Konkludojmë se, pasurimi me aktivitete në kuadrin e lëndëve të ndryshme dhe diskutimi i rastevteve studimore nga vendi, është plotësues i literaturës të teksteve mësimore që është kryesisht e bazuar në ekonomitë e zhvilluara.</p> <p><i>Evidenca 2.7. Aktivitete të Departamentit të Ekonomisë dhe Financës</i></p>


Konkluzione	<i>UNYT në përputhje me dispozitat e ligjit 80/2015, ka siguruar pjesëmarrjen e studentëve në vendmarrje. Shumë të rëndësishëm janë për institucionin alumni, të cilët ftohen në institucion për të ndarë eksperiencën e tyre me studentët aktual.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X






III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT


Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Në nenin 6, gërma c, të Rregullës të programit të studimit, metodat e mësimdhënies, përcaktohen mënyrat e ofrimit të programit të studimit përmes leksioneve, seminarëve, workshop -eve etj. Studentët bazohen në tekste primare dhe sekondare shkencore, materiale të axhornuara dhe, mundsitë që ofrohen nga platforma e -Learning. Mënyrat e mësimdhënies janë të përcaktuara në Syllabusin e secilës lëndë në mënyrë të detajuar. Metodot e mësimdhënies përfshijnë leksione, seminare, tutoriale, instruksione ndërvepruese, punë individuale dhe punë në grup, detyra klase dhe detyra shtëpie.</p> <p>Në planin mësimor konstuam se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ka lëndë që për të njëjtën ngarkesë në auditor 30 orë leksione dhe 15 orë seminar, kanë numër të ndryshëm kreditesh. Për shembull “Aplikime kompjuterike” ka 6 ECTS, ndërsa “Bazat e manaxhimit” ka 8 ECTS. Për “Aplikime kompjuterike”, si pjesë e ngarkesës detyra/projekte janë vlerësuar 60 orë ndërsa studim individual 45 orë, ndërsa për “Bazat e menaxhimit”, detyra dhe projekte 85 orë dhe studim individual 70 orë; 2. Ka lëndë që kanë një ngarkesë të ndryshme në auditor dhe të njëjtën numër kreditesh. Për shembull “Mikroekonomi I”, ka ngarkesë 30 orë leksioni dhe 15 orë seminari dhe ka 6 ECTS, ndërsa “Kalkulus I” ka 30 orë leksioni dhe 30 orë seminari si ka gjithashtu 6 ECTS. Në “Mikroekonomi I”, janë përcaktuar 15 orë detyra/projekte dhe 90 orë studim individual ndërsa në “Kalkulus I”, 40 orë detyra/projekte dhe 50 orë studim individual; <p>Kompensimi i orëve në auditor është bërë me detyra/ projekte dhe studim individual. Të gjitha lëndët e programit Bachelor përmbajnë zërin detyra/ projekte, të cilat vlerësohen nga 15 orë minimumi deri në 85 orë maksimumi dhe, orë të studimit individual që variojnë nga 40 orë deri në 90 orë. Konstatohet se kriteri ligjor i përcaktuar në pikën 2.1/b, VKM nr. 41, datë 24.1.2018, e ndryshuar, “një krediti i korrespondojnë 25 orë mësimore pune studentit”, plotësohet.</p>


	<p><i>Rekomandojmë që të rishikohen orët e detyrave/projekteve dhe studimit individual. Ngarkesa në auditor, duhet të ketë një lidhje të qartë me kreditet e lëndës.</i></p> <p><i>Evidenca 1.10. Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>Evidenca 2.14. Syllabuset</i></p> <p><i>Evidenca 2.1. Plani mësimor</i></p>																		
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se fusha e studimit dhe e specializimit e pedagogëve që japin mësim në këtë program studimi, përputhet me lëndët me të cilat ata japin mësim. Pedagogët janë të angazhuar dhe në kualifikimin e vazhdueshëm. Ata kanë përfshirë në mësimdhënie edhe teknologjinë duke përdorur platformat online, që mundësojnë materiale shtesë për kurset, si për shembull emeraldinsight.com, MC GrawHill etj. Konstatohet se krahas formave të larmishme të mësimdhënies, kemi dhe një përfshirje të konsiderueshme të studentëve në projekte shkencore të organizuara në rang departamenti dhe fakulteti. Përfshirja e studentëve, krijon mundësi për vënien në aplikim të njohurive të përfitura gjatë shkollimit dhe fitimit të aftësive të reja, të punës në grup, të vlefshme për të qenë konkures në tregun e punës. <i>2.5. Tabela përmbledhëse</i></p>																		
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Nga vizita në institucion, konstatuam se pedagogët marrin financime për të ndjekur konferenca dhe për të publikuar artikuj në revista shkencore me faktor impakti.</p> <p>Aktivitetet kërkimore shkencore, konferenca dhe botime në revista me faktor impakti.</p> <table border="1" data-bbox="564 1308 1350 1476"> <thead> <tr> <th colspan="2">2020-2021</th> <th colspan="2">2021-2022</th> <th colspan="2">2022-2023</th> </tr> <tr> <th>Konf.</th> <th>Revista</th> <th>Konf.</th> <th>Revista</th> <th>Konf.</th> <th>Revista</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>3</td> <td>1</td> <td>3</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>2</td> </tr> </tbody> </table> <p>Pedagogët janë të angazhuar në nëntë projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. Në dispozicion të procesit të mësimdhënies, është platforma online Zoom, biblioteka online ku UNYT ka bashkëpunim me Suny/esc.edu/library; esmeraldingsight.com and MC GrawHill.</p> <p><i>Evidenca 2.7. Aktivitete të Departamentit të Ekonomiksit dhe Financës</i></p> <p><i>Evidenca 2.12. Rezultatet e kërkimit shkencor</i></p>	2020-2021		2021-2022		2022-2023		Konf.	Revista	Konf.	Revista	Konf.	Revista	3	1	3	1	1	2
2020-2021		2021-2022		2022-2023															
Konf.	Revista	Konf.	Revista	Konf.	Revista														
3	1	3	1	1	2														

<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p><i>Evidenca 2.5. Tabela përmbledhëse (tabela 17, 20)</i></p> <p>Programi i studimit mbulohet kryesisht me pedagogë të brendshëm, të cilët japin mësim në lëndë në përputhje me kualifikimet dhe fushën e studimit të tyre. Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie si dhe përditësimi i syllabusit në përputhje me kërkesat e tregut të punës në vend, janë objektiva të vendosura nga Departamenti, të cilat reflektohen në lëndët e ofruara në forma të ndryshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lektorë të ftuar si pjesë e orëve mësimore në lëndë si “Auditim”; - vlerësimi i vazhdueshëm gjatë gjithë vitit. Në syllabuset e lëndëve provimi përfundimtar nuk zë më shumë se 40% të vlerësimit total. Projektet/ detyrat e kursit, punët në grup dhe individuale, aktivizimi gjatë orës së mësimit, nxit mendimin kritik dhe përgjegjshmërinë e studentëve; - angazhimi i studentëve në projekte në rang Departamenti dhe Fakulteti; - përfshirja e studentëve në konkurse, duke vënë në zbatim njohuritë teorike të fituara; - përfshirja e praktikës “Inteshipit”, në syllabus si lëndë më vete që në vitin e dytë të studimeve; <p><i>Evidenca 2.5. Tabela përmbledhëse (tabela 2)</i></p> <p><i>Evidenca 2.14. Syllabuset</i></p> <p><i>Evidenca 1.13. Objektivat e Departamentit</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatojmë se Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës, përgjegjës për programin e studimit, pas analizës vjetore të punës, harton objektivat për vitin e ri akademik, si dhe planin e masave që duhet të merren me qëllim përbushjen e këtyre objektivave të vendosura. Në fund të vitit akademik bëhet një rishikim i objektivave të vendosura nga Departamenti, për të vlerësuar ecurinë e përbushjes së tyre. Për secilin vit akademik, bëhet vlerësimi i performancës individuale të pedagogëve, që japin mësim. Në këtë vlerësimim përfshihen puna kërkimore - shkencore, mësimdhënia si dhe detyrat administrative dhe angazhimet të tjera në UNYT.</p> <p>NJSBC harton një raport semestral, për drejtësinë në vlerësim, transparencën, krahasueshmërinë dhe auditimin, gjatë 3-4 javëve të semestrit vijues. Drejtuesi i Departamentit zgjedh në mënyrë rastësore kurset e ofruara nga Departamenti që do të</p>

	<p>analizohen. Për këto kurse hartohet një pyetësor me disa rubrika. Disa nga pyetjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - A përputheshin aktivitetet e vlerësimit me syllabusin e miratuar? - A ishin testimet në përputhje me nivelin e kursit? - A përputhen testet me objektivat e kursit, përmbajtjen, qëllimin, objektivat? - A ishte i drejtë vlerësimi? - A ka pasur raste të inflacionit ose deflacionit të notave? - A është vlerësimi në përputhje me komponentët e përcaktuar në syllabus? <p>Për secilin semestër, shpërdahen pyetësorë vlerësimi për studentët. Pyetësi përban edhe pyetje të hapura, gjithashtu studentët mund të bëjnë komente dhe të japin sygjerime për kurset, për mësimdhënien, për programin e studimit dhe universitetin.</p> <p><i>Evidenca 1.13; 1.16. Objektivat e Departamentit</i> <i>Evidenca 1.14; 1.18. Raporti vjetor i punës së Departamentit</i> <i>Evidenca 1.15; 1.17. Vlerësim i performacës individuale</i> <i>Evidenca 1.19. Raporti i NJSBC</i> <i>Evidenca 6.9. Formular vlerësimi nga studentët</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Në përmbushje të përcaktimeve të nenit 103, të ligjit 80/2015, UNYT ka ngritur NJSBC. Bazuar në nenin 33, të Statutit të UNYT, NJSBC, vlerëson periodikisht, rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore -shkencore në bashkëpunim me Komisionin e Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë, sipas përcaktimeve të Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë. NJSBC funksionon me rregullore të veçantë.</p> <p>Bazuar në <i>nenin 5</i> të Rregullores së NJSBC, disa nga detyrat e kësaj njësie janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Paraqitja e një përmbledhje të dhënash mbi procesin dhe programet e studimit; - Vlerësimi i koordimit të procesit mësimor -arsimor dhe veprimtarisë kërkimore; - Vlerësimi i strukturës, cilësinë dhe zhvillimin e stafit akademik;

	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, konstatojmë se NJSBC, për përmbushjen e detyrave të saj organizon në mënyrë periodike pyetësorë për studentët për secilën lëndë në të gjitha programet e studimit dhe përpunon dhe analizon të dhënat e përfituara, sipas përcaktimeve të pikës 3 të ligjit 80/2015.</p> <p>Konstatojmë se kjo njësi harton 3 raporte:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Raport të vlerësimit nga kolegët; 2. Raport mbi vlerësimin e paanësisë, transparencës, kalueshmërisë dhe auditimit; 3. Raport i vlerësimit të performacës individuale; <p><i>Evidenca 1.1. Statuti</i> <i>Evidenca 6.3. Rregullore për NJSBC</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Në programin e studimit përdoren metoda të ndryshme të mësimdhënies, duke përfshirë edhe teknologjinë me qëllim përmbushjen e objektivave të programit të studimit. Sfati akademik është kompetent dhe ka kualifikimet e nevojshme për lëndët që mbulon.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Në seksionin D, të Rregulles së Departamentit, janë të përcaktuara të gjitha kriteret, që lidhen me procesin mësimor. Në <i>nenin 23</i>, pika c, të Rregullores së Departamentit dhe, neni 32 të Rregullores të Programit të studimit është përcaktuar vlerësimi për secilin kurs sipas raportit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Provim përfundimtar 40%; - Provim në mes të semestrit 30%; - Aktivitete 20%; - Pjesëmarja 10%;

Në *nenin 24* të Rregullores së Departamentit dhe, *nenin 33* të Rregullores të Programit të studimit janë përcaktuar kriteret për të hyrë në provimin përfundimtar:

- Frekuentimi i studentëve, të paktën 70% të pjesëmarrjes në klasë (dhe 75%);

- studentët duhet të marrin pjesë në provimin në mes të semestrit dhe, të kenë marrë minimalisht 10 pikë;

Konstatojmë se Rregullorja e programit të studimit ka kriter frekuentimi 75% dhe Rregullorja e Departamentit 70%. Neni 39, gërma (a) e Rregullores të programit të studimit: “UNYT kërkon 75% të pjesëmarrjes për secilën lëndë”.

Në *nenin 34 dhe 35* të Rregullores të programit të studimit, janë përcaktuar kriteret e marrjes pjesë në provimin e munguar me shkak dhe provimi make -up. Të cilat janë të shpjeguara dhe në procedurën e provimeve. Kriteret e kalimit të lëndës janë të përcaktuara në *nenin 36* të Rregullores të programit të studimit si dhe në *nenin 7*, të Procedurës së provimeve. Për të kaluar një lëndë, studentët duhet të kenë, minimumi 10 pikë nga provimi përfundimtar ose provimi make -up dhe, minimumi 50 pikë në total nga pjesëmarrja, aktivitete të tjera dhe provimi i ndërmjetëm.



Në *nenin 37*, të Rregullores të programit të studimit, si dhe në procedurën e provimeve, është i përcaktuar vlerësimi i studentëve në sistem pikësh në 100, nota me gërmë dhe, pikë cilësie ku maksimumi është 4. UNYT ka hartuar protokollin e provimeve. Në pikën 7, të protokollit të provimeve përcaktohet se: “Çdo student që ka përfunduar 75% të ngarkesës mësimore, por nuk ka arritur të plotësojë 20% të tjerë për arsye serioze, nuk mund të jetë ngelës por mund të vlerësohet me një përqindje të caktuar nga nota maksimale. Nëse vendosni të jepni studentit notë jo të plotë, studenti është i detyruar të paraqesë detyra kursi të papërfunduara deri në mesin e semestrit tjetër.”

Nga vizita në institucion, takimi me studentët, konstatojmë se Rregulloret, procedura e provimeve dhe, protokollin e provimeve janë publike për studentët e kursit.



Konstatojmë se në këtë program studimi, nuk ngrihen komisione për vlerësimin e studentëve, përfshi dhe projektin e diplomës që vlerësohet vetëm nga pedagogu drejtues. Bazuar në këtë fakt, kontrolli për përmbushjen e objektivave të kursit dhe drejtësinë në vlerësim, duhet të jetë i madh.

1.9. Rregullore e Departamentit

	<p>1.10. Rregullore e Programit të Studimit</p> <p>2.4. Procedura e provimeve</p> <p>2.9. Protokoli i provimeve</p> <p>2.14. Syllabuset</p>																				
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Nga vizita në institucion konstatojmë se në fillim të çdo lënde, pedagogu përgjegjës informon studentët me detaje për lëndën duke vënë në dispozicion të tyre syllabusin. Forma e syllabusit, është në përputhje me shtojcën 2, të VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar. Studentëve u bëhet e qartë forma e kontrollit të dijeve dhe frekuentimi. Në <i>nenin 23</i>, pika c, e Rregullores së Departamentit dhe, <i>neni 32</i> e Rregullores të Programit të studimit, si dhe tabela përblehëse 27, është përcaktuar vlerësimi për secilin kurs sipas raportit</p> <table border="1" data-bbox="555 667 1347 954"> <thead> <tr> <th>Komponenti</th> <th>Vlerësimi</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Provimi përfundimtar</td> <td>40 pikë</td> </tr> <tr> <td>Provimi i ndërmjetëm</td> <td>30 pikë</td> </tr> <tr> <td>Komponentë të tjerë</td> <td>20 pikë</td> </tr> <tr> <td>Pjesëmarrja aktive</td> <td>10 pikë</td> </tr> </tbody> </table> <p>Nga shqyrtimi i syllabuseve, konstatojmë se jo të gjithë lëndët, janë bazuar në këtë pikëzim. Për shembull në lëndën “Statistikë II”, krahas provimit të ndërmjetëm është përfshijë në vlerësim dhe test, në vend të komponentëve të tjerë:</p> <table border="1" data-bbox="555 1196 1347 1482"> <thead> <tr> <th>Komponenti</th> <th>Vlerësimi</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Provimi përfundimtar</td> <td>30 pikë</td> </tr> <tr> <td>Provimi i ndërmjetëm</td> <td>30 pikë</td> </tr> <tr> <td>Test</td> <td>30 pikë</td> </tr> <tr> <td>Pjesëmarrja aktive</td> <td>10 pikë</td> </tr> </tbody> </table> <p>Në disa lëndë si për shembull “Kontabilitet Financiar”, provimi përfundimtar dhe provimi i ndërmjetëm janë me peshë të barabartë 35 pikë. Nga vizita në institucion, takimi me pedagogët, na u komunikua, se ndonëse është miratuar në rregullore një formë standarte vlerësimi, secili pedagog në varësi të lëndës, bazuar në lirinë akademike, mund të bënte përshtatje. <u>Rekomandojmë që ky fakt të reflektohet dhe në rregullore.</u></p> <p>Në disa prej syllabuseve, komponentë të tjerë janë të përcaktuara zërat e vlerësimit, psh “Kontabilitet manaxherial”, detyra</p>	Komponenti	Vlerësimi	Provimi përfundimtar	40 pikë	Provimi i ndërmjetëm	30 pikë	Komponentë të tjerë	20 pikë	Pjesëmarrja aktive	10 pikë	Komponenti	Vlerësimi	Provimi përfundimtar	30 pikë	Provimi i ndërmjetëm	30 pikë	Test	30 pikë	Pjesëmarrja aktive	10 pikë
Komponenti	Vlerësimi																				
Provimi përfundimtar	40 pikë																				
Provimi i ndërmjetëm	30 pikë																				
Komponentë të tjerë	20 pikë																				
Pjesëmarrja aktive	10 pikë																				
Komponenti	Vlerësimi																				
Provimi përfundimtar	30 pikë																				
Provimi i ndërmjetëm	30 pikë																				
Test	30 pikë																				
Pjesëmarrja aktive	10 pikë																				

	<p>shtëpie 10 pikë dhe projekte 10 pikë. Ka lëndë që nuk i <u>specifikojnë zërat e komponentëve të tjerë.</u></p> <p><i>Rekomandojmë që zëri komponentë të tjerë, që ka në vlerësim 20%, të specifikohet në të gjitha syllabuset e lëndëve.</i></p> <p><i>Evidenca 2.14. Syllabuset</i></p> <p><i>Evidenca 2.5. Tabelat përbledhëse (tabela 15)</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Bazuar në syllabuset, konstatojmë se testimi i njohurive është i bazuar në vlerësimin e vazhdueshëm të studentëve. Kusht për të marrë pjesë në provimin përfundimtar është pjesëmarrja në provimin e ndërmjetëm dhe marrja e të paktën 10 pikëve nga ky provim nga 30 pikë në total. Vlerësimi i vazhdueshmëm përfshin dhe komponentë të tjerë që zënë në total 20 pikë. Këta komponentë në varësi të kursit përfshijnë projekte individuale, punë në grup, ese, detyra shtëpie, detyra klase dhe raste studimi. Për vlerësimin e bërë në lëndë të ndryshme, hartohet raporti i transparencës së notës për çdo vit akademik, i cili bazohet në kontrollin e testeve të studentëve.</p> <p>Me qëllim analizimin e përmbushjes së objektivave të kursit në përputhje me syllabusin, për çdo kurs përdoret vlerësimi nga kolegët, që konsiston në ndjekjen e kursit nga kolegë të fushës. Në këtë vlerësim përfshihet procedura e mësimdhënies, nxitja e pjesëmarrjes së studentëve gjatë orës së mësimi. Metodrat që përdoren në mësimdhënie, si prezantimet power point, shkruajta në dërrasë, raste studimore. Mënyra e organizimit të detyrave të klasës, ndarja e punës në grup, materialet e përdorura gjatë kursit etj., me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të kursit dhe ruajtjen e standartit të cilësisë.</p> <p><i>Evidenca 1.20. Komunikim i vlerësimit të transparencës</i></p> <p><i>Evidenca 6.4. Formular vlerësimi nga kolegët</i></p> <p><i>Evidenca 2.14. Syllabuset</i></p>
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Departamenti me qëllim që të vlerësojë punën e pedagogëve, në funksion të cilësisë të mësimdhënies, përdorimit të literaturës të fundit, rasteve studimore nga vendi dhe më gjerë, harton në mënyrë periodike pyetësorë të cilët plotësohen nga studentë, duke marrë direkt mendimin e tyre dhe formularë të vlerësimit të lëndës nga kolegë të të njëjtës fushë. Në këtë mënyrë, analizohen me detaje të gjitha aspektet e procesit të mësimdhënies dhe të angazhimit të tyre gjatë orës së mësimi.</p> <p><i>Evidenca 6.4. Formular vlerësimi nga kolegët</i></p>

	<i>Evidenca 6.9. Formular të vlerësimit nga studentët</i>			
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	<p>Për çdo student është përcaktuar një pedagog udhëheqës. Ndër detyrat e pedagogut udhëheqës është monitorimi i progresit të studentit. Pedagogu udhëheqës bashkëpunon me studentët dhe planifikon kurset që janë më të përshtatshme për ta gjatë semestrave vijues deri në diplomim. E gjithë veprimtaria është e regjistruar në platformën GNOMON. UNYT përdor platforma të ndryshme në funksion të mësimdhënies dhe kontrollit të dijeve. Mund të përmendim platformën Moodle, platformën e -learning.</p> <p><i>Evidenca 2.14. Syllabuset</i></p> <p><i>Evidenca 3.2. Detyrat e pedagogëve udhëheqës</i></p> <p><i>Evidenca 3.8. Platforma e provimit në klasë</i></p> <p><i>Evidenca 3.9. Platforma e-Learning</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Bazuar në Rregulloren e programit të studimit, nuk janë parashikuar komisione me qëllim vlerësimin e studentëve. Rekomandojmë që për të paktën projektin e diplomimit, studentët të kenë mundësi ta prezantojnë para një komisioni, me qëllim që të njihen me punimet e studentëve të tjerë dhe cilësinë e tyre.</i></p> <p><i>Rekomandojmë që zëri komponentë të tjerë, që ka një peshë 20% në vlerësim, të specifikohet për të gjitha syllabuset e lëndëve.</i></p> <p><i>Rekomandojmë që të reflektohet në Rregullore, mundësia për të devijuar nga standarti i vlerësimit të miratuar për vlerësimin përfundimtar dhe të vazhdueshëm gjatë vitit dhe ndoshta të përcaktohen kufi.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.



Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve


Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve

Bazuar në *nenin 32*, pika c, të Rregullores të programit të studimit vlerësimi për secilën lëndë, provimi përfundimtar zë


<p>dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>40%, ndërsa vlerësimi i vazhdueshëm gjatë vitit zë 70%. Në vlerësimin e vazhdueshëm, 30% është provimi i ndërmjetëm, 20% aktivitete të tjera dhe 10% pjesmarrja aktive. Bazuar në syllabuset e programit të studimit, në zërin aktivitete të tjera, përfshihen: detyra klase, detyra shtëpie, ese, detyra kursi, punë në grup.</p> <p><i>Evidenca 1.10. Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 2.14. Syllabuset</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Përdorimi i platformave online, është i parashikuar në Rregulloren e programit të studimit, në <i>nenin 6</i>, gërma c, dhe është përdorur në të gjitha kurset gjatë pandemisë Covid -19. Pas përfundimit të pandemisë, studentët testohen në auditor.</p> <p>Nga vizita në institucion dhe shqyrtimi i dokumentacionit, konstatojmë se sisteme elektronike janë përdorur si gjatë fazës së mësimdhënies, ashtu edhe në vlerësimin e pjesshëm dhe përfundimtar të studentëve. Më konkretisht, platformat e përdorura për provimin në klasë “Moodle”, “e -learning”, janë përdorur masivisht gjatë pandemisë. Është në diskrecionin e secilit pedagog, që të përdorë platforma on line, për testimin e studentëve, pas periudhës të pandemisë. Të dhënat për platformat online që përdoren nga programi i studimit janë në tabelën 17, tabelat përmbledhëse. Struktura e teknologjisë përfshin anëtarësimin në Gnomon që prej nëntorit 2021, në Oracle, Red Hat Academy Partners dhe Turnin që prej vitit 2021.</p> <p><i>Evidenca 1.10. Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 3.8. Platforma e provimit në klasë</i> <i>Evidenca 3.9. Platforma e -learning</i> <i>Evidenca 2.5. Tabelat përmbledhëse (tabela 17)</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, konkludojmë se zbatohen në mënyrë rigorozë, rregullat e kalimit të kursit dhe sistemi i vlerësimit, i pasqyruar në <i>nenin 36 dhe 37</i> të Rregullores së programit të studimit. Për të qenë kalues në një lëndë, studenti duhet të ketë frekuentuar të paktën 75%, të ketë marrë pjesë në provimin e pjesshëm ku të ketë marrë minimumi 10 pikë, nga provimi përfundimtar gjithashtu duhet të ketë marrë minimumi 10 pikë, në total për të gjithë komponentët e vlerësimit, 50 pikë. Grada kaluese është C që është ekuivalente me 2.00/4.00 ose 50/100.</p>

	<p>Vlerësimi më i lartë, gada A nga 90-100 pikë, ose 4.00 pikë cilësie. Mënyra e vlerësimit është pasqyruar në syllabusin e çdo lënde dhe studentët janë të informuar.</p> <p><i>Evidenca 1.10. Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>Evidenca 2.14. Syllabuset</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe dokumentacioni, konstatohet se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Studentët kanë në dispozicion kalendrin akademik, në të cilin janë të përcaktuara periudhat e regjistrimit, provimi i ndërmjetëm, provimi përfundimtar; - Edhe pas periudhës së pandemisë Covid -19, janë përdorur platforma online, kryesisht Turnitin për kontrollin për plagjaturë të punëve individuale të studentëve dhe për projektin e diplomimit; - Komunikimi i vlerësimit të detajuar, bëhet online me anë të platformës e -Gnomon, duke ruajtur diskrecionin e vlerësimit të çdo studenti. Studenti informohet në këtë platformë për mungesat, detyrat e shtëpisë, esetë, vlerësimin e vazhdueshëm gjatë vitit, vlerësimin përfundimtar. Platforma është interaktive duke krijuar mundësi për vendosjen e komenteve për detyra të realizuara në kuadër të kursit; <p><i>Evidenca 1.10. Komunikimi i vlerësimit</i></p> <p><i>Evidenca 3.5. Kalendari akademik</i></p> <p><i>Evidenca 3.8.2. Përdorimi i platformës Turnitin për provim final në klasë</i></p> <p><i>Evidenca 4.20. Platforma Gnomon.png</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatohet se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të gjitha detyrat që përbëjnë vlerësimin e vazhdueshëm gjatë vitit, përfshi dhe temën e diplomës hidhen on line në platformën Turnitin dhe bëhet verifikimi për plagjaturë; - Në syllabuset e lëndëve është e përcaktuar se “UNYT nuk toleron pandershmërinë akademike. Të gjitha detyrat e hedhura në Turnitin nuk duhet të kalojnë nivelin 10% të plagjarizmit, ndryshe do të vlerësohen me pak pikë. Detyrat me 25% ose më shumë plagjaturë do të vlerësohen me notën F”. Studentët janë të informuar nga pedagogët e lëndëve në fillim të çdo kursi, për këtë politikë të UNYT; - Në kodin e ndershmërisë së studentit, është e përcaktuar politika antiplagjaturë e institucionit, si dhe penaltet. Në



	<p>konstatimin për herë të parë të plagjaturës, studenti vlerësohet me notën “F”, për të gjithë kursin. Në konstatimin për herë të dytë (jo detyrimisht në të njëjtin kurs), studenti përjashtohet nga UNYT;</p> <p>- Studentët japin dakortësinë e tyre, duke firmosur për pranimin e rregullave të vendosura nga institucioni për plagjaturën;</p> <p>- Neni 17, i Kodit të Etikës, ka të përcaktuar se studentët nuk duhet të kryejnë plagjaturë, duke respektuar Kodin e ndershmërisë së studentit, për të cilin kanë dhënë dakortësinë duke e firmosur. Nuk lejohet mbajtja e celularëve ose pajisjeve të tjera elektronike të ndezura në klasë gjatë orëve të provimit;</p> <p><i>Evidenca 2.14. Syllabuset</i> <i>Evidenca 3.7. Kodi i ndershmërisë së studentit</i> <i>Evidenca 4.7. Kodi i etikës</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Bazuar në <i>nenin 11</i>, të Procedurës së provimeve, rezultatet e provimit duhet të dërgohen në sekretari në formë të printuar dhe në mënyrë elektronike, nga pedagogu i kursit pas 5 (pesë) ditëve pune pas datës së provimit. Bazuar në Rregulloren e programit, provimi përfundimtar dhe ai i ndërmjetëm zhvillohet me shkim. Kjo lehtëson kontrollin e vlerësimit nga NJSBC, e cila harton një raport semestral, në lidhje me drejtësinë e vlerësimeve, ndershmërinë, krahasimin dhe auditin. Pas realizimit të kontrollit nga kjo njësi, për të gjithë komponentët e procesit të vlerësimit.</p> <p><i>Evidenca 1.19. Raporti i NJSBC për vlerësimin e transparencës</i> <i>Evidenca 2.4. Procedura e provimeve</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e</p>	<p>Bazuar në <i>nenin 43</i> të Rregullores të programit të studimit, notat e dhëna nga personeli mësimor hidhen në sistemin e informacionit të studentëve. Bazuar në <i>nenin 45</i>, gërma a, të Rregullores të Programit dhe <i>nenit 10</i> të Procedurave të provimeve, nëse studenti nuk është i kënaqur me vlerësimin përfundimtar, atëherë ka të drejtë të paraqesi kundërshtim me shkrim për rezultatin e provimit në Zyrën e Çështjeve Studentore brenda 48 orëve. Zyra e Çështjeve studentore dërgon kërkesën tek Drejtuesi i Departamentit brenda 48 orëve. Nëse Drejtuesi i Departamentit konsideron se janë përmbushur kushtet e nevojshme, i kërkon personelit akademik të bëjë rivlerësim. Vlerësimi i Drejtuesit dhe rivlerësimi përfundon brenda 48 orëve.</p>




ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Nëse studenti nuk është i kënaqur me rezultatin e rivlerësimit, ka të drejtë të kërkojë që të krijohet komisioni <i>ad-hoc</i> me anë të kërkesës me shkrim drejtuar Dekanit të Fakultetit, brenda 24 orëve. Dekani i fakultetit jep vendimin e komisionit brenda 5 ditëve pune.			
	<i>Evidenca 1.10. Rregullore e programit të studimit</i>			
	<i>Evidenca 2.4. Procedura e provimeve</i>			
Konkluzione	<i>Kriteri ligjor përmbushet plotësisht nga institucioni. Vlerësimi i vazhdueshëm gjatë gjithë vitit, bën që pedagogët të njohin aftësitë dhe shikojnë progresin e studentit gjatë kursit. Përdorimi i platformës kundërplagjaturës, garanton drejtësi në vlerësimin e punëve të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Në <i>nenin 6</i> , të Rregullores të programit të studimit, është përcaktuar përgatitja e studentëve me aftësi dhe kompetenca për të qenë konkures në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. - Në profilin “Ekonomiks”, studentët aftësohen për të gërshetuar njohuri të përfituara në lëndë si matematika, statistika, ekonometria etj., për të ndërtuar parashikime ekonomike, për të shpjeguar mënyrën e funksionimit të ekonomisë në periudhën afatshkurtër dhe afatgjatë. - Në profilin “Financë dhe kontabilit”, studentët aftësohen që të analizojë informacionin financiar me qëllim vendimmarrjen, të ndërtojnë modele financiare dhe fiskale. <i>Evidenca 1.10. Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 2.14. Syllabuset</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin	Programi i studimit ofron në të tre profilet lëndën “Aplikime kompjuterike”, që njeh studentët me elementë thelbësorë të

<p>e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>teknologjisë së kompjuterave. Lëndët “Statistikë I” dhe “Statistikë II”, të cilit rrisin aftësinë e studentëve për të bërë analiza të thjeshta të dhënash, të krijojnë dhe ruajnë baza të dhënash dhe të njohin programe specifike si SPSS që mundësohen në kuadrin e këtyre lëndëve.</p> <p>Lënda “Ekonometri”, për profilin “Ekonomiks” dhe “Financë”, mundëson që studentët të ndërtojnë regresione për variabla të interesit dhe të analizojnë ecurinë e tyre në kohë, duke rritur aftësitë e tyre përpunuese të të dhënave. Lënda ka aplikance të programeve për përpunimin e të dhënave si STATA.</p> <p>Lënda “Metoda kërkimore në shkencat e aplikuara”, ofrohet në të tre profilet. Në këtë lëndë theksohet roli i ekonometrisë në kërkimin empirik në financë, kontabilitet dhe ekonomiks.</p> <p><i>Evidenca 1.10. Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>Evidenca 2.1. Plani mësimor</i></p> <p><i>Evidenca 2.14. Syllabuset</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Në raportin vjetor të punës të Departamentit, bëhet një analizë e detajuar e punës si në lidhje me mësimdhënien ashtu dhe me kërkimin shkencor dhe angazhimin e studentëve në kërkimin shkencor. Analizohen aspekte të ndryshme si kalueshmëria, nota mesatare, materialet e përdorura në mësimdhënie, përfshirja e ekspertëve vendas për konkretizim me raste studimore nga vendi, në kuadër të lëndëve të veçanta të programit. NJSBC harton raport semestral për vlerësimin e transparencës së notës, e cila merret në konsideratë në Raportin vjetor të Departamentit dhe shërben për përmirësim të mëtejshëm të programit të studimit. Disa nga momentet kryesore të raportit të transparencës:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Analizohet nëse aktivitet e zhvilluara gjatë kursit janë në përputhje me ato të miratuara në Syllabus; - Nëse niveli i testeve është në nivelin e kursit; - Nëse testet kanë arritur qëllimin, objektivat e kursit; - Nëse vlerësimi i studentëve ka qenë i drejtë; - Nëse notat e vendosura janë në përputhje me sistemin e pikëzimit të miratuar; - Nëse formati përfundimtar i vlerësimit, reflekton ose jo peshën e komponentëve të ndryshëm të syllabusit;

	<p><i>Evidenca 1.14. & 1.18. Raporti vjetor i Departamentit</i></p> <p><i>Evidenca 1.19. Raporti i NJSBC për vlerësimin e transparencës</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikant profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Departamenti organizon aktivitete me lektorë të ftuar, të cilët sjellin eksperiencën Shqiptare, në fushën ku ata punojnë duke pasuruar me raste studimore programin e lëndëve të veçanta. Për vitin akademik 2020-2021, ka pasur dy lektorë të ftuar.</p> <p>Studentët janë angazhuar në konkursin SML 2022, për bursën të zhvilluar nga DSIK Albania. Ku kanë mundur të aplikojnë njohuritë teorike të përfituara gjatë shkollës. Pedagogët e Departamentit janë të angazhuar në programe shkëmbimit. Për vitin akademik, 2020-2021 kanë marrë pjesë në International Erasmus week të organizuar në Kroaci, në vitin akademik 2021-2022 kanë marrë pjesë në Erasmus Mundus në Turqi.</p> <p>Pedagogët e programit të studimit janë të angazhuar në konferenca ndërkombëtare dhe kanë botuar artikuj shkencorë me faktorë impakti. Nga vizita në institucion kontaktuar se ata, përdorin pjesë të kërkimit të tyre shkencor në mësimdhënie, duke rritur rastet studimore ilustruese të temave. Pjesëmarrja në programet Erasmus, ka rritur aftësinë e tyre të mësimdhënies, duke vënë në aplikim praktikant më të mira.</p> <p><i>Evidenca 2.7. Aktivitete në Departament</i></p> <p><i>Evidenca 3.14. Konkursi SML</i></p> <p><i>Evidenca 1.14. & 1.18. Raporti vjetor i Departamentit</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik në funksion të programit të studimit, ka realizuar 4 botime dhe 4 aktivitete shkencore. Është pjesëmarrës në 9 projekte kombëtare, ka zhvilluar 9 seminare me lektorë të huaj, ka realizuar 7 prezantime në konferenca ndërkombëtare.</p> <p><i>Evidenca 2.7. Aktivitete në Departament</i></p> <p><i>Evidenca 1.14. & 1.18. Raporti vjetor i Departamentit</i></p> <p><i>Evidenca 2.5. Tabelat përmbledhëse (tabela 19, tabela 20)</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Konstatohet se, programi i studimit në të tre profilet, i ka kushtuar rëndësi të veçantë formimit të njohurive analitike të studentëve, duke i bërë ata më konkurrues në treg. Aktivitetet e zhvilluara në kuadër të programit, si dhe përfshirja e studentëve në konkurse ndërkombëtare, ku dhe janë shpallur fitues, është një e dhënë për suksesin e programit.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X


Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Në <i>nenin 29</i>, të Rregullores të programit të studimit si dhe në <i>nenin 4</i> të Rregullores të diplomimit, janë përcaktuar kushtet e regjistrimit në projektin e diplomimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - studenti duhet të ketë përfunduar praktikën; - studenti duhet të ketë marrë 144 ECTS; - studentë me lëndë të mbetura nga viti i parë nuk mund të regjistrohen në projektin e diplomimit; - çdo student i caktohet një pedagog udhëheqës; <p>Projekti i diplomimit është një punë individuale, e cila demonstroi aftësitë analitike dhe njohuritë teorike të përfituara nga studenti. Supervizori i projektit, i cili caktohet në fillim të kursit nga departamenti e udhëzon dhe ndihmon studentin për të realizuar temën e zgjedhur. Projekti i diplomimit kalon kontrollin e plagjaturës me software, për të cilën studentët kanë dakortësuar duke firmosur, për të gjithë punimet gjatë ciklit bachelor. Ngjashmëritë nuk mund të kalojnë 25% në total me përjashtim të kuotimeve direkte dhe referencave.</p> <p><i>Evidenca 1.10. Rregullorja e programit të studimit</i> <i>Evidenca 3.3. Rregullore e projektit të diplomimit</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>UNYT ka të specifikuar detyrat e pedagogëve udhëheqës, të cilët takimet me studentët i regjistrojnë në sistemin Gnomon. Regjistrimi i këshillimit ka qëllim të dyfishtë, së pari përdoret për të vlerësuar takimet këshilluese nga administrata dhe së dyti, në rast të ankesave është prova e përmbushjes së detyrimit të këshillimit. Takimi zyrtar bëhet të paktën një herë në semestër. Bazuar në <i>kapitullin III</i>, të Rregullores të projektit të diplomimit, studenti duhet të zbatojë programin e aktiviteteve të përcaktuar nga udhëheqësi. Pedagogu udhëheqës, në përmbushje të nenit 4, pika 4, duhet që të përcaktojë afatet, takimet, në përputhje me syllabusin që në fillim të semestrit.</p>

	<p>Projekti i diplomimit, është kurs i rregullt. Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës, ka hartuar një manual për projektin e diplomimit. Manuali lehtëson punën e shkruajtjes të projektit, tërheq vëmendjen për citimet në tekst, burimin e të dhënave, literaturën, si dhe kontrollin për plagjaturë. Në manual jepet një strukturë e temës si template që duhet të ndiqet nga studentët.</p> <p>Sudentët gjatë ciklit Bachelor ndjekin dy kurse të shkrimit akademik, “Shkrim akademik I” dhe “Shkrim akademik II”, si veprimtari e detyrueshme për të tre profilet, duke lehtësuar punën individuale të diplomës, pasi të gjithë studentët kanë njohuri të nevojshme, të përfituara nga këto dy lëndë, për të shkruajtur në përputhje me standartet e kërkuara.</p> <p><i>Evidenca 3.2. Detyrat e pedagogëve udhëheqës</i> <i>Evidenca 3.3. Rregullorja e projektit të diplomimit</i> <i>Evidenca 3.3.1. Manual për projektin e diplomimit</i> <i>Evidenca 2.1. Plani mësimor</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Bazuar në <i>nenin 29</i>, të Rregulles të programit të studimit, të gjithë studentët e bachelorit, në të tre profilet, janë të detyruar të regjistrohen në projektin e diplomimit, i cili rregjistrohet si lëndë e rregullt. Në UNYT nuk aplikohet provim përfundimtar për testim të njohurive. Ligji 80/2015, në <i>nenin 73</i>, pika 2, përcakton “<i>Studentët e programit të ciklit të parë të studimeve diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose diplomë.</i>”</p> <p><i>Evidenca 1.10. Rregullore e programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 4: Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orientojnë dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë</p>	<p>Bazuar në <i>nenin 29</i>, <i>gërmanin 29</i>, të Rregullores të programit të studimit, dhe <i>nenin 5</i>, pika 3 e Rregullores të projektit të diplomimit, angazhimet dhe nota në drejtim të projektit të diplomimit përcaktohet nga udhëheqësi i projektit të diplomimit, sipas plan programit në fillim të semestrit. Projekti i diplomimit, regjistrohet si lëndë normale me detyrim, në semestrin e II, viti i tretë i studimeve dhe, ka një syllabus të miratuar. Kursi ka të parashikuar 10 orë në auditor, konsulta me supervizorin. Është kurs orjentues në lidhje me kërkesat e shkrimit të projektit të diplomimit. Roli i supervizorit është përcaktuar në <i>nenin 5</i>, të Rregullores të projektit të diplomimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - inkurajimi i studentëve të shqyrtojnë literaturën e përshtatshme;

<p>për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>- aplikimimi i metodologjisë të përshtatshme bazuar në literaturë; - ofrimi i mbështetjes së përgjithshme, dhe udhëzimi gjatë gjithë procesit;</p> <p><i>Konstatohet se, nuk ka komision për projektin e diplomimit. Diploma dorëzohet dhe vlerësohet me notë nga pedagogu drejtues.</i></p> <p><i>Evidenca 1.10. Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 2.14.1. Syllabusi i projektit të diplomimit</i> <i>Evidenca 3.3. Rregullorja e projektit të diplomimit</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e programit të studimit dhe Rregulloren e projektit të diplomimit, pedagogu udhëheqës, udhëzon studentët në të gjitha fazat për punimin e temës së diplomës, rishikimin e literaturës, zgjedhjes së metodologjisë së përdorur në bazë të rishikimit të literaturës, i udhëzon për faqet online, ku mund të marrin të dhënat. Në varësi të temës, pedagogu udhëheqës asiston për hartimin e pyetësorëve për studime specifike të tregut. Për përpunimin e të dhënave shfrytëzohen programet që janë vënë në dispozicion nga programi i studimit të tilla si SPSS, STATA, etj.</p> <p><i>Evidenca 1.10. Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 3.3. Rregullorja e projektit të diplomimit</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Projekti i diplomimit regjistrohet si lëndë me detyrim dhe ka syllabus të miratuar. Syllabusi planifikon 10 orë në auditor. Studentët duhet të kenë një frekuentim të paktën 75%, me qëllim që të mbrojnë temën e diplomës. Tema kontrollon me programin për plagjaturë. Vlerësimi është notë e shprehur në shkronjë. Nota kaluese minimale është C, përqindja 50-59, ose pikëzimi 2.00 dhe vlerësimi maksimal është nota A, përqindja 90-100, ose pikëzimi 4.00.</p> <p><i>Evidenca 2.14.1. Syllabusi i projektit të diplomimit</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në</p>	<p>Bazuar në nenin 49, të Rregullores të programit të studimit, studentët që kanë fituar 180 ECTS dhe kanë GPA 2.0/4.0 (50/100), diplomohen në ciklin bachelor. Lëshimi i diplomës, kërkon që studentit të plotësojë formularin e diplomimit, të ketë leje nga zyra e bibliotekës, IT dhe financës. Diploma lëshohet e nënshkruar nga Dekani dhe Rektori. Sipas përcaktimeve të nenit 5, të Rregullores së programit të studimit, nëse studentit</p>

<p>dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>ka përfunduar me sukses studimet bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profil Ekonomiks, do të pajiset me një diplomë dy gjuhëshe me emërtim Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profil Ekonomiks. Në mënyrë të ngjashme veprohet për profilin “Financë” dhe “Kontabilitet”.</p> <p>UNYT ka të hartuar procedurën e diplomimit, e cila ndahet në pesë faza. (i) identifikimi i studentëve të ardhshëm për tu diplomuar, (ii) miratimi institucional i statusit të të diplomuarve, (iii) lëshimi i diplomës, lista zyrtare e notave dhe shtojcës të diplomës, (iv) dorëzimi i diplomës, (v) arkivimi dhe rikthimi në arkivë i të diplomuarve. Diploma e nënshkruar së bashku me listën e notave dhe shtojcën e diplomës mbyllet në zarf të vulosur dhe dorëzohet nga zyra e regjistrit, që mban një regjistër të dorëzimit të diplomave, me firmën e të diplomuarit ose të përfaqësuesit të autorizuar prej tij. Lëshimi i diplomës dhe suplementit të diplomës është në përputhje me përcaktimet e nenit 91 të ligjit 80/2015.</p> <p><i>Evidenca 1.10. Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>Evidenca 3.6. Procedura e lëshimit të diplomës</i></p> <p><i>Evidenca 3.12. Diploma & suplementi</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Procedura e lëshimit të diplomës përfshin dhe fazën e arkivimit. Procesi i arkivimit të diplomës, listës zyrtare të notave dhe shtojcës së diplomës të të diplomuarve është parashikuar në rregulloren e arkivës të UNYT. Kopje elektronike dhe të stampuara të diplomave dhe shtojcave të diplomave ruhen gjithashtu në arkivën e rektoratit, ndërsa të dhënat elektronike të të gjithë listë notave mbahen nga zyra e regjistrit. Sipas ligjit të arsimit të lartë nuk lëshohet dublikatë diplome. Bazuar në <i>nenin 30</i>, të Rregullores të sekretarisë mësimore, dhe <i>nenin 25</i> të Rregullores të arkivës, vlerësimet e studentëve, mirëmbahen dhe ruhen nga sekretaria mësimore në mënyrë të përhershme. Kopje elektronike e tyre ruhet në një vend tjetër përveç sekretarisë mësimore.</p> <p>Bazuar në <i>nenin 19</i> të Rregullores të arkivës, pranë sekretarisë mësimore mirëmbahen dhe ruhen në mënyrë të përhershme Regjistrat Themeltar (Amzat), Regjistrat e arritjeve akademike dhe Regjistrat e lëshimit të diplomave dhe vërtetimeve.</p> <p><i>Evidenca 3.6. Procedura e lëshimit të diplomës</i></p>

	<i>Evidenca 5.4. Rregullore e brendshme për veprimtarinë e sekretarisë mësimore</i>		
	<i>Evidenca 5.5. Rregullore e arkivës</i>		
Konkluzione	<i>Konstatohet se institucioni, zbaton një procedurë të qartë për detyrimet përmblyëse, në përputhje me ligjin 80/2015 dhe mbrojtjen e të dhënave personale.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1													
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.													
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve												
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	<p>Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile “Ekonomiks”, “Financë” dhe “Kontabilitet” është Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit, i cili është organizuar në tre njësi kryesore si më poshtë, në përputhje me legjislacionin në fuqi (sipas të cilit një Fakultet organizohet në të paktën tre njësi përbërëse nga të cilat të paktën dy janë departamente):</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i “Administrim Biznesit; 2. Departamenti i “Ekonomiksit dhe Financës”; 3. Departamenti i “Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit”; <p>Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit gjatë vitit akademik 2022-2023 ka angazhuar gjithsej 36 staf akademik , nga ku 23 janë staf akademik efektiv (PAE) dhe 13 staf akademik me kontratë (PAK) me kualifikimin si më poshtë:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th> <th colspan="2">Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>2</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof.Asoc</td> <td>2</td> <td>1</td> </tr> </tbody> </table>		Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit		PAE	PAK	Prof.Dr	2	-	Prof.Asoc	2	1
Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit												
	PAE	PAK											
Prof.Dr	2	-											
Prof.Asoc	2	1											

Dr/PhD	10	9
Msc	9	3
Gjithsej	23	13

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, të dhënat për stafin e angazhuar në mësimdhënie për programin Bachelor në “Ekonomiks dhe Financë me profile “Ekonomiks”, “Financë” dhe “Kontabilitet”” për gjatë tre viteve të fundit akademike janë si më poshtë:

1. Për vitin akademik 2020 - 2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 14 pedagogë nga të cilët 10 PAE dhe 4 PAK (72% / 28%):
2. Për vitin akademik 2021 - 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 7 pedagogë nga të cilët 7 PAE dhe 0 PAK (100% / 0 %):
3. Për vitin akademik 2022- 2023 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 17 pedagogë nga të cilët 13 PAE dhe 4 PAK (76 % / 24 %):

Kualifikimi i stafit akademik të PS	2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr	1	-	-	-	-	-
Prof. Asoc.	1	1	3	-	1	-
Dr/Phd	1	-	1	-	5	3
Msc.	7	3	3	-	7	1
Gjithsej	10	4	7	0	13	4

GVJ vlerëson se personeli akademik që angazhohet në këtë program studimi ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për mësimdhënien dhe mbulimin e të gjitha aktiviteteve bashkëshoqëruese të një programi studimi Bachelor, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi.

Evidenca 2.5 UNYT Tabelat përmbledhëse tabela nr.7

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Nga verifikimi i të dhënave statistikore (ref. Tabelave 12.1, 12.2,12.3), u konstatua se për tre vitet akademike mbi 70% e ngarkesës mësimore është mbajtur nga personeli akademik efektiv, PAE. Konkretisht:

	Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)
	2020-2021	2720	2465	255	91% / 9%
	2021-2022	2065	1885	180	91% / 9%
	2022-2023	3290	2853	437	87% / 13%

Evidenca 2.5 UNYT Tabelat përmbledhëse tab 12.1, 12.2 12.3

Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.

Në përgjithësi, në bazë të dokumentave të paraqitura dhe takimeve të kryera gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se UNYT ka një eksperiencë shumë të mirë në punësimin e një stafi cilësor me dëshirë për t'u kualifikuar, dhe që demonstroi qëndrueshmëri në vite, pike e forte kjo e këtij program.

Evidenca 2.5 UNYT Tabelat përmbledhëse
Evidenca 4.25.2 Formati standard i procedurës së punësimit
Shënime gjatë vizitës

Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.

Procesi i rekrutimit parashikohet në Statut dhe në Rregulloren e UNYT. Kërkesat për staf të ri adresohen nga Departamenti dhe procesi bashkëshoqërohet nga Zyra e Burimeve njerëzore.

UNYT përdor dy formatet kryesore të kontratave:

- për stafin me kohë të plotë dhe stafin me kohë të pjesshëm dhe kontratë 1 vjeçare me afat të përcaktuar për stafin me kohë të plotë, me titull MSc;
- Kontratat e stafit me kohë të plotë, i cili mbulon dhe detyra menaxheriale/administrative si për shembull Pergjegjës Departmenti, Dekan, përmbajnë specifika të veçanta;



Procesi i rekrutimit bëhet publik në media. Procesi vijon me mbledhjen e kandidaturave, shqyrtimin e dosjeve nga Komisioni i ngritur posaçërisht, dhe përfundon me intervistat e kryera nga Komisioni i Vlerësimit, i përbërë nga Zv. Rektori, Administratori, Dekani dhe Përgjegjësi i Departamentit përkatës. Për personelin akademik fitues kontrata nënshkruhet nga Rektori.

Evidenca 4.27: Anekset e Kontratave
Evidenca 4.28: Kontratë Pune me kohë të plotë me afat të pacaktuar
Evidenca 4.28.1: Kontratë Pune me kohë të pjesshme

	<i>Evidenca 4.28.2: Kontratë Pune me kohë të plotë me afat të përcaktuar</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Përsa i përket mirëmbajtjes së laboratorëve, zyra e TI-së përbëhet nga dy specialistë të cilët ndjekin realizimin e orëve laboratorike dhe mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	<p>Gjatë takimit me përfaqësuesen e kësaj zyre, GVJ konstatoi se kjo zyrë plotëson, ruan dhe përditëson të dhënat mbi anëtarët e personelit akademik të angazhuar në programet e studimit që ofron UIYT në formën e dosjeve personale të personelit.</p> <p>Në mënyrë rastësore, GVJ shqyrtoi dosjen personale të dy pedagogëve të programit të studimit (një me kohë të plotë dhe një me kontratë) dhe konstatoi se dosja ishte e plotësuar me dokumentet e nevojshëm si: CV, kontrata e punës, diplomat dhe kualifikimet, librezat shëndetësore etj. Por në dosjen e personelit nuk paraqitej evidenca e fituesit (sa pikë kishte marrë, cilët ishin aplikantët), por vetëm vendimi.</p> <p>Nga vizita në institucion, u konstatua se Zyra e Burimeve Njerezore ka iniciuar unifikimin e resumeve të stafit akademik sipas APA style, me qëllim transparencën institucionale, të gjitha jetëshkrimet janë të publikuara në faqen zyrtare të UNYT https://unyt.edu.al/index.php/faculty/</p>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	<p>UNYT disponon një zyrë të veçantë për udhëzimin drejt karrierës dhe për praktikat profesionale. Kjo zyrë ka krijuar marrëveshje me institucione të ndryshme, të cilat mundësojnë realizimin e praktikave profesionale për studentët.</p> <p>Për programin Bachelor ne Ekonomiks dhe Finance, praktika profesionale është e integruar në një lëndë specifike e Internshipit në semestrin e dytë të vitit të dytë të studimeve. Kjo praktikë kryhet në ambjentet e institucionit, i cili raporton pjesëmarrjen dhe punën praktike.</p> <p><i>Evidenca 1.22: Raporti i Internship</i> <i>Evidenca 2.14: Syllabuset e Lendeve</i> <i>Evidenca 5.1: Lista e MoU</i></p>

<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p><i>Evidenca 5.11: Rregullore Zyra e Karrieres, Alb</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Personeli akademik që angazhohet në këtë program studimi ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për mësimdhënien në programin e studimit Bachelor, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi.</i> - <i>Ngarkesa mësimore e personelit akademik efektiv të angazhuar në këtë program studimi është në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</i> - <i>Pranë Departamentit përgjegjës së programit ka qëndrueshmëri të personelit akademik efektiv.</i> <p><i>Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të UNYT mbledh, ruan dhe përditëson të dhënat e personelit akademik të angazhuar me kohë të plotë dhe me kontratë. Në dosjen e personelit nuk paraqitej evidenca e fituesit (sa pikë kishte marrë, cilët ishin aplikantët), por vetëm vendimi.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi IV.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e</p>	<p>UNYT siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore garanton infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të nivelit të parë, nivelit të dytë dhe programeve të</p>






<p>veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>integruara të nivelit të dytë që ofron. Studentët kanë aksesin në të gjitha ambjentet e nevojshme për zhvillimin e një procesi mësimor me kushte modern. Sallat e leksioneve, biblioteka, labororet me teknologji moderne, janë më se të përshtatshme për zhvillimin e metodave moderne të mësimdhënies. UNYT po kryen një investim të ri dhe UNYT do të zhvillojë aktivitetin e tij në dy kampuse. Në kampusin kryesor të UNYT, ekziston një bibliotekë fizike dhe elektronike që lejon studentët e UNYT të lexojnë artikuj shkencorë ose libra elektronikë https://unyt.edu.al/index.php/facilities/</p> <p><i>Evidenca 4.4: Akt miratim Main_Building Higjeno-Sanitar_2018</i></p> <p><i>Evidenca 4.10: Kontratë Qiraje</i></p> <p><i>Evidenca 4.12: Sipërfaqja në funksion të mësimdhënies</i></p> <p><i>Evidenca 4.13: Ambientet e Bibliotekës</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Pavarësisht se ky program studimi nuk parashikon kryerjen e orëve laboratorike, UNYT ofron laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimi për studentët. GVJ vizitoi disa salla leksionesh dhe seminaresh, bibliotekën dhe mjedise të tjera në përdorim të përbashkët dhe vuri re që mjediset, sipas funksionit të tyre, ishin të pajisura edhe me kompjutera, projektorë dhe lidhje interneti, si dhe kishin ndriçim dhe ajrosje optimale për kryerjen e aktivitetit mësimor.</p> <p>Në takimet me personelin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmoi se ambientet ku zhvillohet mësimi plotësojnë normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme sipas kuadrit rregullator në fuqi.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p><i>Evidenca 4.17: IT Shërbimet, Alb</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të</p>	<p>UNYT ofron laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme për t'i shërbyer programit të studimit Bachelor "Banking dhe Financë e aplikuar". Laboratorët janë të pajisur</p>

teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	me programe profesionale në mbështetje të kurrikulës së programit, si: Turnitin, Office 365, SPSS dhe Libraritë online: JSTOR (terminated), EMERALD (terminated). Gjithashtu studentët disponojnë akses në Revista shkencore si dhe në bazën e të dhënave të ESC.			
	<i>Evidenca 4.1: Raporti i Literaturës</i>			
	<i>Evidenca 4.9: Politika dhe Procedura e Bibliotekës</i>			
	<i>Evidenca 4.13: Ambientet e Bibliotekës</i>			
	<i>Evidenca 4.17: IT Shërbimet, Alb</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i>			
	<i>UNYT ka ambiente të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor. Infrastruktura dhe teknologjia është mëse e përshtatshme për programin e studimit</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjediset të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Nga sylabuset e lëndëve, GVJ konstaton se literatura e bazë dhe ndihmëse e lëndëve të Programit të studimit Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile “Ekonomiks”, “Financë” dhe “Kontabilitet” ofrohet në gjuhën e programit të studimit (anglisht). Kjo literaturë plotëson të gjitha kriteret për të dhënë njohuritë e kërkuara për këtë program studimi. <i>Evidenca 2.14: Syllabuset e Lëndëve</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Drejtuesi i Departamentit përgjegjës për këtë program studimi planifikon së bashku me stafin, nevojën për tituj librash, duke e planifikuar blerjen e tyre në buxhetin vjetor. <i>Evidenca 4.9: Politika dhe Procedura e Bibliotekës</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke	UNYT vë në dispozicion bibliotekën, që ndodhet në katin e 2 nëntokësor të godinës. Biblioteka është e aksesueshme në mënyrë të barabartë nga të gjithë studentët. Biblioteka është e

<p>garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>kompletuar me tituj librash dhe me hapësirë me kompiutera, duke iu siguruar studentëve një ambient bashkëkohor për studim.</p> <p><i>Evidenca 4.14: Ambientet e bibliotekës</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët e këtij programi, GVJ konstatoi se ata kanë mundësi të përdorin pa pagesë si literaturën fizike dhe online në bibliotekë. http://library.unyt.edu.al/ Studentët dhe stafi akademik mund të huazojnë materiale me anë të kartave të tyre të identitetit dhe kartës së studentit, dhe pa pagesë.</p> <p>Biblioteka e UNYT përdor sistemin LibrarySoft (Formati MARC) për rregjistrimin e materialeve, dhe sistemin e klasifikimit të Bibliotekës së Kongresit si politikat dhe procedurat e katalogimit të koleksionit kryesor. Literatura sigurohet përmes porosive të bibliotekës dhe burimeve elektronike prestigjioze [JSTOR, Emerald Insight, PROQUEST, EBSCOhost, APA, SAGE etj. [http://unyt.edu.al/facilities-3]], të aksesueshme jo vetëm në ambientet e bibliotekës, por edhe nga laboratorë të tjerë brenda kampusit, madje disa nga jashtë kampusit. Biblioteka e UNYT siguron tituj të përshtatshëm për programin e studimit Bachelor “Banking dhe Financë e Aplikuar”.</p> <p><i>Evidenca 4.9: Politika dhe Procedura e Bibliotekës</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Zona e Kompjuterave ndodhet brenda ambienteve të bibliotekës dhe ka 12 kompjutera të lidhura në rrjet në dispozicion për studentët si dhe ofron një shërbim printimi falas. E gjithë zona e bibliotekës është e mbuluar me lidhje wireless.</p> <p><i>Evidenca 2: RVB Programi i studimit Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile “Ekonomiks”, “Financë” dhe “Kontabilitet”</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave,</p>	<p>Biblioteka e Universitetit me bibliotekare eksperte operon çdo ditë të javës nga ora 09.00- 20.00 dhe në fundjavë deri në orën 18.00. Orari i Bibliotekës është i afishuar në hyrje të bibliotekës dhe në faqen elektronike; [http://unyt.edu.al/facilities-3].</p>



numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	<p><i>Evidenca 2: RVB Programi i studimit Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile "Ekonomiks", "Financë" dhe "Kontabilitet"</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>		
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe në takimet gjatë vizitës në UNYT, GVJ vlerëson se institucioni angazhohet në mënyrë aktive lidhur me cilësinë e fondit fizik të bibliotekës, përditësimin dhe shkallën e shfrytëzimit të saj.</p> <p>Bibloteka gjatë veprimtarisë së saj ditore mban statistika mbi frekuentimin dhe përdorimin e saj nga personeli akademik dhe studentët, të cilat i raporton në evidencat mujore në Rektorat dhe tek Administratori i UNYT. Përditësimi i biblotekës bëhet në bazë të rekomandimeve të stafit, duke u rritur cilësia e fondit fizik të biblotekës dhe asaj online.</p> <p><i>Evidenca 2: RVB Programi i studimit Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile "Ekonomiks", "Financë" dhe "Kontabilitet"</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <p><i>Literatura bazë dhe ndihmëse e Programit të studimit Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile "Ekonomiks", "Financë" dhe "Kontabilitet"</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>përmbushin objektivat e tij të studimit dhe u mundësojnë studentëve të marrin njohuritë e nevojshme të parashikuara në program.</i> - <i>Biblioteka ofron infrastrukturën e nevojshme për akomodim dhe shfrytëzim optimal në mënyrë të barabartë nga studentët dhe pedagogët e të gjithë programeve të studimit të UNYT.</i> <p><i>Institucioni angazhohet në mënyrë aktive lidhur me cilësinë e fondit fizik të bibliotekës, përditësimin dhe shkallën e shfrytëzimit të saj.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.4

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423


E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Referuar RVB-se dhe vizitës në institucion, UNYT që prej vitit 2003 ka në përdorim një sistem të menaxhimit të informacionit (GNOMON) në lidhje me studentët, të dhënat e tyre personale, të dhënat akademike si dhe plan programet në të cilët studentët janë të regjistruar.</p> <p>Studentët finalizojnë regjistrimin e tyre në UNYT sipas portalit U-Albania, ata dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar si pjesë e dosjes personale të tyre, dosje e cila i shoqëron ata deri në momentin e diplomimit. Zyra e Çështjeve të Studentëve ka kryer procesin e parë të regjistrimit të studentëve kandidatë në sistemin e menaxhimit dhe me finalizimin e regjistrimit është Zyra e Financës ajo që e sjellë studentin në vitin e caktuar në sistemin e menaxhimit. Më pas, Sekretaria mësimore merret me hedhjen e të dhënave personale të studentëve. Pas këtij procesi dosjet e studentëve janë në përdorim nga Sekretaria dhe ruhen në ambientet e saj.</p> <p><i>Evidenca 4.20: Platforma Gnomon</i></p> <p><i>Evidenca 5.4: Rregullore e brendshme për veprimtarinë e sekretarisë mësimore, Alb</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në Institucion u konstatua se pranë në zyrës së Burimeve Njerëzore, organizohet informacioni sipas dosjeve të stafit akademik dhe administrativ.</p> <p>Përsa i përket menaxhimit të informacionit dhe dokumentacionit të personelit akademik, personelit ndihmës akademik dhe personelit administrativ të angazhuar në realizimin e programit, ky informacion është i organizuar sipas dosjeve të posaçme të stafit, në mënyrë fizike, por edhe elektronike.</p> <p>Ne gnomon emri instruktorit dhe advisor regjistrohet nga records. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione dhe dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit duke u mundësuar të gjithë stafit akademik, administrativ dhe studentëve të UNYT hapjen e një adrese elektronike e cila shërben për rritjen e cilësisë së komunikimit brenda institucionit.</p>

	<p>Gjithashtu, gjatë vizitës në sekretarinë e UNYT, GVJ verifikoi me zgjedhje dosjen e plotë të dy studentëve të Programit të studimit Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile “Ekonomiks”, “Financë” dhe “Kontabilitet” dhe përdorimin e regjistrave përkatës (themeltar, të arritjeve akademike & të lëshimit të diplomave) sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi.</p> <p><i>Evidenca 2: RVB Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile “Ekonomiks”, “Financë” dhe “Kontabilitet”</i></p> <p><i>Evidenca 1.1. Statuti i UNYT</i></p> <p><i>Shënime gjatë vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Gjatë periudhës së pandemisë, UNYT ka mundësuar zhvillimin e kurseve të mësimit online. Janë përdorur platformat si: McGraw Hill dhe PersonMyLab, si dhe është implementuar “e-platforma” elektronike, udhëzues për metodat e mësimdhënies, manual për hartimin/riorganizimin e një programi studimi si dhe guida për mësimdhënien online. Gjithashtu është përdorur sistemi i menaxhimit (Gnomon) për të dhënat në lidhje me studentët dhe plan programet.</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Referuar RVB-Së, sistemi i menaxhimit (Gnomon) mundëson nxjerrjen e të dhënave të ndryshme që lidhen me studentët apo plan programet dhe përdoren nga Sekretaria mësimore për qëllime të ndryshme. Të dhënat që zakonisht gjenerohen nga sistemi i menaxhimit janë listat e notave të studentëve, lista e notave në bazë kursi, listë-prezencat për kurset respektive, të gjitha këto i përkasin ecurisë akademike në UNYT. Nga ana tjetër, të dhënat e tjera që nxirren nga sistemi i menaxhimit kanë të bëjnë me raportime të ndryshme që Sekretaria mësimore ben si pjesë e punës së saj. Të dhënat janë kryesisht lista emërore të studentëve apo raportime statistikore.</p> <p><i>Evidenca 4.21: Akses i profesoreve</i></p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - UNYT përdor disa platforma për administrimin e informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre; - Informacioni që lidhet me të gjitha programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet & projektet, publikohet në faqen zyrtare të institucionit në internet;


Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>UNYT realizon raport vjetor, ku bën analizë kostoje, analizë të ardhurash dhe analizë fitim/humbje. Mbi bazën e këtyre tre analizave, menaxhimi i universitetit në bashkëpunim me departamentin dhe njësinë e financës, marrin masat për të gjithë sistemimet, ndërhyrjet që duhen bërë për vitin e ardhshëm akademik. Analiza e fitimit / humbjes kryhet për secilin program dhe nëse është e nevojshme modifikimet e duhura të komponentëve të caktuar të kostos bëhen për vitin e ardhshëm akademik.</p> <p><i>Evidenca 4.33: Pasqyrat financiare 2020</i> <i>Evidenca 4.33.1: Pasqyrat financiare 2021</i> <i>Evidenca 4.35: Raporti kosot-efektivitet</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të</p>	<p>Mënyrat e financimit të këtij program studimi realizohen nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> - tarifat vjetore të studentëve; - financim nga Fondacioni Turk MAARIF; - projektet kërkimore shkencore; <p>Çdo njësi bazë në UNYT në periudhën Prill- Maj bën hartimin e buxhetit sipas skemës nga poshtë lart. Buxheti nis nga nevojat e departamentit për staf akademik, investime e shpenzime operationale, projeksionet e studentëve sipas programeve për vitin e ardhshëm akademik. Projekt – Buxheti, si rregull kalon miratohet në Senat dhe në Bordin e Administrimit të UNYT, e shërben më pas si plan financiar për administrimin e universitetit.</p> <p><i>Evidenca 4.31: Plan Buxheti</i> <i>Evidenca 4.34: Procedurat e buxhetimit</i></p>

studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>UNYT është institucion jo publik i arsimit të lartë, për pasojë aktiviteti tregtar rregullohet edhe nga Ligji Nr.9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare“, i ndryshuar. Shoqëria ka detyrim ligjor përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe Ligjin Nr.25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare“ si dhe publikimin e tyre pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB). Qëllimi i raportit të auditimit është të sigurojë arritjen e objektivave në kategoritë e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Efektshmëria dhe efikasiteti i operacioneve; • Besueshmëria e raportimit financiar dhe menaxhimit; • Pajtueshmëria me politikat dhe rregulloret në fuqi; <p><i>Evidenca 4.30: Raporti i Auditimit</i> <i>Evidenca 4.33: Pasqyrat financiare 2020</i> <i>Evidenca 4.33.1: Pasqyrat financiare 2021</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>UNYT manaxhon dhe garanton qëndrueshmërinë e institucionit, mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe garantimin e studentëve përgjatë gjithë ciklit të studimit, si dhe garantimin në këtë mënyrë të qëndrueshmërisë së stafit akademik dhe administrative.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Nga pasqyrat financiare (ku evidentohet humbja) evidentohet që qëndrueshmëria financiare garantohet nëpërmjet donacioneve nga Fondacioni Turk Maarif. Pavarësisht kësaj, domosdoshmëria e rritjes së numrit të studentëve, e ndryshimit të politikave pëqasjen më të madhe të studentëve në UNYT, del si domosdoshmëri për të cilën UNYT duhet të mendojë strategjikisht.</p> <p><i>Evidenca 4.33: Pasqyrat financiare 2020</i> <i>Evidenca 4.33.1: Pasqyrat financiare 2021</i> <i>Evidenca 4.31: Plan Buxheti</i> <i>Evidenca 4.34: Procedura e buxhetimit</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - UNYT harton raporte financiare në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator sipas programeve të studimit;

	<p>- <i>Institucioni i nënshtrohet kontrollit dhe auditimit të brendshëm dhe të jashtëm;</i></p> <p><i>UNYT granton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit, përmes donacioneve nga Fondacioni Turk Maarif. Pavarësisht kësaj, fakti që aktualisht program del me humbje, çon tek domosdoshmëria e rritjes së numrit të studentëve, e ndryshimit të politikave pëqasjen më të madhe të studentëve në UNYT, del si domosdoshmëri për të cilën UNYT duhet të mendojë strategjikisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës IV	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X



V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1



Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Kushtet e pranimin, regjistrimit dhe matrikullimit të studentëve janë të përcaktuara në <i>nenin 62</i> të Rregullores së Universitetit. UNYT pranon studentë konform përcaktimeve të <i>nenit 74</i> të ligjit 80/2015, duke shtuar kërkesën për njohjen e gjuhës angleze, pasi mësimi zhvillohet në anglisht. Kriteret e pranimin janë të përcaktuara në <i>nenin 6</i>, të Rregullores të programit të studimit. Kuotat e pranimin, miratohen nga Senati i UNYT, në përputhje me ligjin 80/2015.</p> <p>Lista e aplikantëve për programin e studimit merret nga U - Albania. Bazuar në aplikimet, shpallet lista e fituesve, e cila është dhe në portalin U -Albania. Çdo person i regjistruar merr numër matrikullimi për të fituar kredite akademike. Studentët e regjistruar dhe matrikulluar, përfitojnë kartën e studentit.</p> <p>UNYT, ka një politikë të mirë bursash për studentët. Një nga mënyrat e fitimit të bursës është provimi. Njoftimi për bursë</p>


	<p>është online në faqen zyrtare të institucionit dhe të gjithë të interesuarit, mund të marrin pjesë. Gjatë viteve të studimit, krahas praktikës që është lëndë e detyruar sipas programit, organizohen dhe panaiere të punës dhe studimit, me qëllim rritjen e mundësisë të studentëve për të vendosur kontakte me tregun e punës para diplomimit.</p> <p><i>Evidenca 1.7. Rregullorja e Universitetit</i> <i>Evidenca 5.3. Kuarat për vitin akademik</i> <i>Evidenca 5.7. Lista e aplikantëve</i> <i>Evidenca 5.8. Lista e fituesve</i> <i>Evidenca 5.9. Karta e studentit</i> <i>Evidenca 5.28. Panairi i punës dhe studimit</i> <i>Evidenca 5.30. Provimi i bursës</i> <i>Evidenca 1.10. Rregullorja e programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>UNYT garanton lirinë akademike dhe siguron mundësi të barabarta, në përputhje me përcaktimet e ligjit 80/2015 dhe aktet nënligjore të tij.</p> <p>Veprimtaria mësimore bazohet në merita akademike, duke përjashtuar diskriminimet e racës, fesë, gjinisë, prejardhjes kombëtare, orjentimit seksual, të origjinës, të gjendjes civile, të aftësive fizike dhe të çdo faktori tjetër. Kodi i etikës i UNYT, është në përputhje me ligjin 80/2015, ligjin 9970 datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore”, ligji 110221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen ndaj diskriminimit”, ligjit 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.</p> <p>UNYT ka ngritur qendrën e mbështetjes akademike dhe këshillimit, e cila ndihmon studentët për të arritur sukses akademik, duke ofruar falas për të gjithë studentët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - drejtim akademik; - mësimdhënie individuale ose në grup; - të mësuarit nga kolegët; - konsultime individuale ose në grup; -seminare; <p><i>Evidenca 1.1. Statuti</i> <i>Evidenca 3.4. Qendra e mbështetjes akademike dhe këshillimit</i> <i>Evidenca 4.7. Kodi i etikës</i></p>


<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e programit të studimit, çdo kandidat që ka përfunduar arsimin e mesëm me sukses dhe plotëson kriteret e notës mesatare të përcaktuar me VKM, mund të aplikojë në portalin U- Albania, për tu regjistruar në këtë program studimi, në përputhje me nenin 74 të ligjit 80/2015.</p> <p>Programi lejon regjistrimin e studentëve të huaj, të cilët në përputhje me <i>nenin 7</i>, gërma d, janë të detyruar që të ndjekin procedurat e njohjes së diplomës dhe ekuivalentimit sipas legjislacionit në fuqi. Ndjekja e procedurave për studentët e huaj bëhet nga Senati. Kriter i veçantë është çertifikata e gjuhës angleze dhe provimi i aftësisë, sipas përcaktimeve të <i>nenit 11</i>, të Rregullores të programit të studimit. Për t'u regjistruar në programin e studimit, UNYT kërkon Certifikatën e nivelit B1 të gjuhës angleze nga TOEFL, IELTS, APTIS dhe çdo provim i përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve.</p> <p><i>Konstatohet se programi i studimit, ka studentë të huaj që ndjekin studimet bachelor, jo në kuadër të programeve të shkëmbimit Erasmus. Kjo tregon për njohjen e programit të studimit përtej kufijve të vendit dhe vlerësimi për të.</i></p> <p><i>Evidenca 1.10. Rregullorja e programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Programi i studimit, pranon studentë të transferuar, në përputhje me ligjin 80/2015. Sipas <i>nenit 9</i>, të Rregullores të programit të studimit, kërkesa e studentëve për transferimin e krediteve rishikohet nga një komision në nivel departamenti ad-hoc dhe aprovohet nga Dekani i fakultetit përkatës. Kreditet e transferuara hyjnë në fuqi me miratimin e rektoratit. Për tu diplomuar, studentët e transferuar duhet të fitojnë të paktën ½ e totalit të krediteve në UNYT. Programi i studimit lejon shkëmbime të studentëve në hyrje dhe dalje. Studentët e regjistruar në institucione të tjera mund të aplikojnë për një nga programet e ofruar në UNYT (Erasmus +, Mevlana ose Marrëveshje bilaterale) me statusin e studentit të shkëmbyer. Këta studentë kanë të drejta të barabarta me studentët e UNYT për procesin mësimor. Në përfundim të periudhës së shkëmbimit lëshohet lista e notave. Studentët e procesit të shkëmbimit në dalje ndjekin të gjitha rregullat e universitetit pritës.</p> <p>Të gjitha kriteret për pranimin e studentëve, transferimet janë të publikuara në faqen zyrtare të UNYT.</p>

<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p><i>Evidenca 1.10. Rregullorja e programit të studimit</i></p> <p>Nga vizita në institucion, konstatoam se kriteret e aplikimit për programin e studimit, janë të disponueshme në faqen zyrtare të fakultetit. Programit të studimit, i bëhet marketing tek shkollat e mesme, për studentë të ardhshëm potencial.</p> <p>Me qëllim që të tërhiqen studentë elitare, UNYT për çdo vit akademik aplikon bursa. Politika e bursave është e afishuar në faqen UNYT. Për çdo vit akademik miratohen kuotat nga bordi i administrimit, sipas propozimit të Rektoratit. Bursat jepen bazuar në potencialin akademik dhe potencialin për të qenë lider i ardhshëm, pa diskriminuar në bazë të besimit fetar, gjinisë, kombësisë etj. Bursa vlerësohet në çdo vit akademik në bazë të notave (GPA). Çdo vit kryet një testim për përfitimin e bursës. Në varësi të rezulteteve të testimit përcaktohet madhësia e bursës. Studentët që marrin nga 65-74 pikë në test përfitojnë 25% të bursës, ndërsa ata që marrin nga 95-100 pikë përfitojnë bursë të plotë. Për studentët që kanë mbaruar shkollën e mesme, ata me mesatare 9 përfitojnë 25% të bursës, ndërsa mesatarja 10 përfiton bursë të plotë.</p> <p><i>Evidenca 5.23. Politika e bursave</i></p> <p><i>Evidenca 5.30. Provimi i bursës</i></p> <p><i>Evidenca 2.8. Marketingu i Departamentit</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentave konstatojmë se, për çdo vit akademik, në kuotat e miratuara nga Senati, ka të përcaktuara kuota për kantidatë më aftësi të veçanta në rang Universiteti.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për vitin akademik 2020-2021, një kuotë për persona me aftësi të kufizuara, 2 kuota për statusin e jetimit, dhe një kuotë nga komuniteti rom; - Për vitin akademik 2021-2022, një kuotë për persona me aftësi të kufizuara, një kuotë për statusin e jetimit, dhe një kuotë nga komuniteti rom; - Për vitin akademik 2022-2023, një kuotë për persona me aftësi të kufizuara, një kuotë për statusin e jetimit, dhe një kuotë nga komuniteti rom; <p><i>Në Fakultetin e Ekonomisë dhe të Biznesit, nuk ka kuota të përcaktuara për kantidatët me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</i></p> <p><i>Evidenca 5.3. Kuotat për vitin akademik</i></p>

<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Për çdo vit akademik, programi i studimit ka vendosur kuota për studentët e huaj. Bazuar në Rregulloren e programit të studimit, studentët e huaj duhet të bëjnë konvertim të diplomës dhe të përmbushin kriteret ligjore të vendosura nga ligji 80/2015, si dhe përcaktimi i notës mesatare që është i vendosur me VKM. Kriter shtesë, janë njohuritë e gjuhës angleze, bazuar në faktin se mësimdhënia zhvillohet në këtë gjuhë. Sipas përcaktimeve të Rregulleres të programit kërkohet minimumi niveli B1. Për studentët që nuk disponojnë çertifikatë, ofrohet provimi i gjuhës angleze i organizuar nga institucioni.</p> <p>Në koutat e miratura për programin e studimit, konstatojmë se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për vitin akademik 2020 -2021, janë miratuar 4 kuota për studentët e huaj; - Për vitin akademik 2020 -2021, janë miratuar 6 kuota për studentët e huaj; - Për vitin akademik 2022 -2023, janë miratuar 6 kuota për studentët e huaj; <p><i>Evidenca 5.3. Kuotat për vitin akademik</i></p> <p><i>Evidenca 1.10. Rregullorja e programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimet në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Nga rishikimi i dokumentacionit, konstatojmë se UNYT ofron bursa për sistemin bachelor:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Bazuar në provimin vjetor që organizon, ku në varësi të rezultateve jepen bursa 25%, 50%, 75% ose 100%; - Bursa për studentë me arritje të veçanta kombëtare dhe ndërkombëtare në shkencë, arte, sporte etj. - Bursa bazuar në mesataren e shkollës së mesme për maturantët. Nota 9 përfiton 25% bursë, nota 9.5 përfiton 50% bursë, nota 9.8 përfiton 75% bursë dhe nota 10 përfiton 100% bursë; - Bursë për studentët që vazhdojnë studimet në UNYT bazuar në GPA. Kjo bursë është semestrale. Për studentët me GPA 3.84+ bursa është 25%, për GPA 3.88+ bursa është 50%, për GPA 3.96+ bursa është 75% dhe për GPA 4.0 bursa është e plotë; - lloje të tjera burse, psh për studentët që transferojnë studimet nga univesite të tjera përfitojnë 25% bursë; <p><i>Evidenca 5.23. Politika e bursave</i></p>


Konkluzione	<i>Konstatohet se kriteret e pranimit, transferimit të studimeve, pjesëmarrjes në Erasmus janë të përcaktuara qartë në përputhje me ligjin 80/2015 dhe publike për të gjithë të interesuarit. Politika e bursës është bazuar në meritokraci duke ofruar disa mundësi për financime të plota ose të pjesshme të studimeve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2


Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>Bazuar në <i>nenin 27</i>, të Rregullores të programit të studimit një student i rregullt regjistron 30 kredite ECTS për semestër. Pas miratimit të Këshilluesit, studenti mund të regjistrojë lëndë shtesë nëse nota mesatare në një sistem të bazuar në 100 pikë është:</p> <ul style="list-style-type: none"> - midis 50-59, maksimumi 30 ECTS; - midis 60-79, maksimumi 36 ECTS (6 kredite janë vetëm për lëndët e humbura ose të mbetura); - midis 80-89, maksimumi 40 ECTS, (10 kredite janë vetëm për lëndët e humbura ose të mbetura); - midis 90-100, maksimumi 45 ECTS, nëse studenti nuk la kë lëndë të mbetur; <p>Programi i studimit përdor platformë online, për vendosjen e mungesave, vlerësimeve të vazhdueshme gjatë vitit si dhe vlerësimeve përfundimtare. Studentët kanë akses online dhe mund të ndjekin progresin e tyre akademik.</p> <p><i>Nga vizita në institucion dhe dokumentacioni i administruar, konstatohet se, programi i studimit është i organizuar me semestra. Nuk ka të përcaktuar një numër kreditesh që duhet të merret për të kaluar në vitin tjetër të studimit. Kufizim ka vetëm për studentët në pozicion diplomimi, ata nuk duhet të kenë lëndë të mbetura nga viti i parë i studimit.</i></p>

	<p><i>Evidenca 1.10. Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>Evidenca 4.21. Aksesimi i profesorëve</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Në përputhje me dispozitat e nenit 89 të ligjit 80/2015, UNYT ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferim të studimeve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda të njëjtit institucion apo institucione të ndryshme të arsimit të lartë. Informacioni për transferimin e krediteve, është i disponueshëm në faqen zyrtare të institucionit.</p> <p>Bazuar në <i>nenin 9</i> të Rregullores të programit të studimit, studentët e transferuar duhet të bëjnë kërkesë për transferimin e krediteve. Të paraqesin programin mësimor (syllabusin) e lëndëve që kërkojnë të transferohen. Kërkesa rishikohet nga komisioni ad -hoc në nivel departamenti dhe aprovet nga dekani. Konstatohet se numri i krediteve të njohura, për studentët e transferuar është 60 (gjashtëdhjetë) ECTS, në përputhje me pikën 2.1, e VKM nr. 41/2018 e ndryshuar.</p> <p><i>Evidenca 5.21. Dokumentat për transferim</i></p> <p><i>Evidenca 1.10. Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>Evidenca 5.24. Komunikimi me studentët ndërkombëtar</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në <i>nenin 32</i> të Rregullores të programit të studimit, vlerësimi i studentëve përcaktohet bazuar në vlerësimin e vazhdueshëm gjatë gjithë vitit. Për secilën lëndë në rregullore është miratuar vlerësimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - provim përfundimtar 40%; - Provim i ndërmjetëm 30%; - Aktivitete të tjera 20%; - Pjesëmarrja aktive 10%; <p>Nga rishikimi i syllabuseve dhe vizita në institucion konstatohet se përgjithësisht lëndët e ofruara në programin e studimit i përmbahen këtij vlerësimi. Për të hyrë në provimin përfundimtar, studentët duhet të kenë frekuentuar në masën 75%, të kenë marrë pjesë në testimin e ndërmjetëm dhe të kenë përfituar të paktën 10 pikë nga ky testim. Për të kaluar një lëndë, studenti duhet të grumbullohet në total në minimum 50 pikë. Të këtë marrë në provimin e përfundimtar minimumi 10 pikë. Studentët vlerësohen në një sistem me notë me gërmë, të cilës i korespondojnë një sistem pikësh deri në 100, dhe pikë cilësie 4.0.</p>





	<p>I gjithë informacioni në lidhje me procesin e vlerësimit është në syllabusin e çdo lënde, e cila i vihet në dispozicion studentëve në fillim të semestrit nga pedagogu i lëndës. Nga vizita në institucion, konstatom se komponenti vlerësime të tjera që zë 20% të notës, në varësi të lëndës, ndahet në detyra klase, ese, projekte duke vënë pikët për çdo detyrë. Nga takimi me studentët, konstatoam se ata kishin informacionin e plotë për detyrimet e lëndës, sistemin e vlerësimit, kërkesat për frekuentim, literaturën bazë dhe atë plotësuese.</p> <p>Këshilluesi akademik është në kontakt të vazhdueshëm me studentët, jo vetëm përsa i përket anës akademike të tyre, duke i ndihmuar dhe orjentuar në zgjedhjen e kurseve, duke parë notat e tyre semestrale dhe përfundimtare, dhe duke i ndihmuar në vështirësi që hasin në lëndë të caktuara.</p> <p><i>Evidenca 1.10. Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>Evidenca 2.14. Syllabuset</i></p> <p><i>Evidenca 3.2. Detyrat e këshilluesit akademik</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në përcaktimet e <i>nenit 19</i> të Rregullores të departamentit, në <i>nenin 29</i> të Rregullores të programit të studimit, si dhe në <i>nenin 4</i> të Rregullores të projektit të diplomimit, që studentët të jenë të regjistruar në lëndën e projektit të diplomimit, për programet e ciklit të parë, duhet të kenë të paktën 144 ECTS, të kenë përfunduar praktikën mësimore, të mos ketë lëndë të mbetura nga viti i parë akademik.</p> <p>Bazuar në <i>nenin 30</i> të Rregullores të programit të studimit, studenti që është në fazë për tu diplomuar i lejohet të regjistrojë një lëndë shtesë për semestër, pavarësisht nga GPA. Kjo lëndë duhet të jetë brenda 45 ECTS maksimale për semestër. Në Rregulloren për projektin të diplomimit për studentët e ciklit bachelor, janë shpjeguar rregullat e projektit të diplomimit, si për shembull kontrolli për plagjaturë, ndekja e udhëzimeve të pedagogut drejtues për afatet e dërgimit të pjesëve të veçanta të punimit si dhe punës përfundimtare.</p> <p><i>Evidenca 1.9. Rregullorja e Departamentit të Financës dhe Ekonomisë</i></p> <p><i>Evidenca 1.10. Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>Evidenca 3.3. Rregullore e projektit të diplomimit</i></p>



<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Zyra për çështjet studentore, është njësia brenda institucionit që merret me marketingun dhe aktivitete të tjera me qëllim tërheqjen e maturantëve të interesuar. Pjesë e planit vjetor të kësaj zyre janë, takime me maturantët jo vetëm në rrethin e Tiranës por në të gjithë vendin. Maturantët mund të vijnë që të vizitojnë ambjentet e UNYT dhe të marrin këshillim karriere nga stafi. UNYT jep bursa në varësi të mesatares për maturantët që duan të vazhdojnë programin e studimit pranë këtij universiteti. UNYT ofron kurse për maturantët pa pagesë, për shembull për lëndët që zhvillohen në provimin e maturës dhe për lëndë të tjera specifike. Programi i studimit ka fletëpalosje, ku shpjegohen programet e ndryshme të bachelorit, që ofrohen nga UNYT. Në faqen e web -it të UNYT, bëhet gjithashtu promovimi i kurseve të ofruara. Të diplomuarit e mëparshëm të UNYT dhe karriera e tyre e suksesshme, janë gjithashtu një promovim shumë i mirë për programin e studimit.</p> <p><i>Evidenca 5.26. Kurse të arkitekturës</i> <i>Evidenca 5.27. Kurse të maturës</i> <i>Evidenca 5.33 Plani vjetor i zyrës për çështjeve studentore</i></p>						
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Konstatohet që studentët kanë të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programin e studimit.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Informacioni i detajuar gjendet në Rregulloren e Departamentit, në Rregulloren e Programit të Studimit që janë të disponueshme online në faqen zyrtare të UNYT.</i> - <i>Informacioni në lidhje me procesin e vlerësimit është në syllabusin e çdo lënde, e cila i vihet në dispozicion studentëve në fillim të semestrit nga pedagogu i lëndës.</i> - <i>Studentët kanë akses online dhe mund të ndjekin progresin e tyre akademik. Programi i studimit përdor platformë online, për vendosjen e mungesave, vlerësimeve të vazhdueshme gjatë vitit si dhe vlerësimeve përfundimtare.</i> 						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="542 1568 727 1686">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="727 1568 922 1686">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="922 1568 1120 1686">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="542 1686 727 1744"></td> <td data-bbox="727 1686 922 1744"></td> <td data-bbox="922 1686 1120 1744" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi V.3




Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Të gjitha informacionet për programet që ofrohen në UNYT, janë të aksesueshme në faqen zyrtare të institucionit. Çdo student i regjistruar ka këshilltar akademik, i cili e informon në lidhje me procesin e mësimdhënies, lëndët që mund të zgjedh çdo semestër, në përputhje me <i>nenin 13</i>, gërma b, të Rregullores të Departamentit.</p> <p>Në <i>nenin 8</i>, gërma c, e Rregullores të Fakultetit, në <i>nenin 6</i> gërma c, e Rregullores të Departamentit, përcaktohet se ofrohet programi bachelor me kohëzgjatje 3 vite studimi, 180 ECTS.</p> <p>Llojet e lëndëve, regjistrimi etj., analizohen me detaje në pjesën F të Rregullores të programit të studimit. UNYT ka të ngritur, Zyrën e marrëdhënieve me studentët, e cila funksionon bazuar në rregullore të miratuar. Kjo zyrë shërben si udhëzues për studentët gjatë gjithë periudhës që ndjekin studimet.</p> <p><i>Evidenca 1.8. Rregullore e Fakultetit</i> <i>Evidenca 1.9. Rregullore e Departamentit</i> <i>Evidenca 1.10. Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 5.31. SAO Rregullore e brendshme</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Nga vizita në institucion, takimi me studentët, konstatuam se ata ishin të mirë informuar për të gjitha aspektet e procesit mësimor. Krahas Rregullores së programit të studimit që ka informacione të detajuar për kursin, dokument që është në dispozicion të studentëve dhe i aksesueshëm online, studentët e marrin informacionin përmes këshilltarit akademik si dhe Zyrës për çështjet studentore. Syllabuset e lëndëve, përmbajnë informacion të detajuar dhe janë në dispozicion të studentëve me anë të platformës online që përdoret në universitet.</p> <p><i>Evidenca 5.31. SAO Rregullore e brendshme</i> <i>Evidenca 2.14. Syllabuset</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit ka nënshkruar 21 bashkëpunime me organizata, ndërmarrje dhe institucione. Studentët e programit të studimit, realizojnë “intership” pranë këtyre institucione dhe kanë mundësi dhe për punësim. Numri</p>

<p>për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>i studentëve për programin e studimit, është i vogël, si rrjedhim studentët kanë mundësi më të madhe zgjedhje.</p> <p>Zyra e karrierës, ndihmon studentët në përgatitjen dhe ndjekjen e karrierës, organizon intershipe, evente dhe panairë karriere, trajnime dhe wokshop -e me qëllim zhvillimin profesional. Nga vizita në institucion dhe takimi me studentët, konkluduar se ata ishin të mirë informuar për mundësitë e punësimit që oftoheshin për degën e tyre. Krahas shpalljes së njoftimeve online në faqen zyrtare të UNYT, njoftimet ishin fizikisht të shpallura në fakultet. Ata merrnin gjithashtu informacion në adresën e email -it të institucionit për aktivitete që zhvillonte Departamenti si dhe për thirrjet për aplikim në programet Erasmus etj.</p> <p><i>Evidenca 5.1. Memorandumet e bashkëpunimit</i></p> <p><i>Evidenca 5.12., 5.13., 5.14., & 5.15. Aktivitete të zyrës së karrierës</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentët që pranohen në programin e studimit, përfshi edhe ata të transferuar ose Erasmus, paraqiten në Zyrën e çështjeve studentore, e cila i ndihmon jo vetëm me dokumentacionin, por i orjenton të aplikojnë në Zyrën e Regjistrimeve për të marrë ID dhe kartën e studentit, i informon rreth infrastrukturës së fakultetit, bibliotekën, sallat e leksionit, labororet etj., duke zhvilluar një guidë në institucion. Për numrin e kurseve që mund të ndjekin në një semestër, regjistrimin në kurse etj., studentët kontaktojnë me këshilltarin akademik.</p> <p>Të gjithë studentët e regjistruar kanë adresë zyrtare email të universitetit, ku marrin informacione për aktivitete të ndryshme që zhvillohen dhe mundësitë që ata kanë për të aplikuar në programe shkëmbimi. Regjistrimi i studentëve në platformat online e-Gnomon, mundëson që ata të ndjekin numrin e mungesave, vlerësimin e vazhdueshëm gjatë vitit, progresin akademik të tyre.</p> <p><i>Evidenca 5.17. Ditët e hapura dhe vizitat e studentëve</i></p> <p><i>Evidenca 4.19. Adresa ekelektronike</i></p> <p><i>Evidenca 4.20.1 E-Gnomon aksesi i studentëve</i></p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit</p>	<p>Krahas informacionit që është i aksesueshëm në faqen zyrtare të UNYT për programin e studimit, studentët progresin akademik të tyre mund ta ndjekin në e-Gnomon, platformë funksionale online për të gjithë studentët e regjistruar.</p>

dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	<i>Evidenca 4.20.1 E-Gnomon aksesi i studentëve</i>		
Konkluzione	<p><i>Informacioni për programin e studimit dhe aktivitet që zhvillohen në funksion të mësimdhënies janë të detajuara. Studentët mund të përdorin disa burime:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - faqja zyrate e UNYT; - këshilluesi akademik; - platforma Gnomon; - email zyrtar; - zyra për karrierën dhe çështjet studentore; 		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.4																											
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.																											
Kriteret		Vlerësimi i ekspertëve																									
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.		<p>Në programin e studimit bachelor, nuk ka akoma të diplomuar. Institucioni ka të dhëna për progresin akademik të studentëve aktual, sipas lëndëve, profileve të studimit dhe vitit akademik ku ata janë të regjistruar.</p> <p><i>Evidenca 5.32. Dokumenti i performancës</i></p>																									
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.		<p>Nga vizita pranë sekretarisë të institucionit, si dhe dokumentacioni i dorëzuar, konkludojmë se institucioni mban të dhëna të sakta të numrit të studentëve të regjistruar dhe të larguar. Programi i studimit akoma nuk ka të diplomuar. Studentët e vitit të tretë bachelor, gjatë vizitës në institucion, po dorëzonin temat e diplomës. Nr. i studentëve të regjistruar dhe çregjistrua bazuar në regjistrin themeltar (nga vizita në institucion):</p> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Viti</th> <th colspan="2">Profili Kontabilitet</th> <th colspan="2">Profili Financë</th> <th colspan="2">Profili Ekonomiks</th> </tr> <tr> <th>Rregjist.</th> <th>larguar</th> <th>Rregjist.</th> <th>larguar</th> <th>Regjist.</th> <th>Larguar</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td> </td> <td> </td> <td> </td> <td> </td> <td> </td> <td> </td> <td> </td> </tr> </tbody> </table>						Viti	Profili Kontabilitet		Profili Financë		Profili Ekonomiks		Rregjist.	larguar	Rregjist.	larguar	Regjist.	Larguar							
Viti	Profili Kontabilitet		Profili Financë		Profili Ekonomiks																						
	Rregjist.	larguar	Rregjist.	larguar	Regjist.	Larguar																					

2020-2021	3	1	2	1	3	-
2021-2022	2	1	19	1	4	2
2022-2023	0		11	-	1	-
Totali	3		30		6	

Nga sekretaria mësimore, morrën informacionin se studentët e çrregjistruar transferohen përgjithsisht brenda fakultetit.

Evidenca 2.5. Tabela përmbledhëse (tabela 21)

Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.

Të dhënat për kurset, mungesat, detyrat dhe projektet, pikët e provimit përfundimtar dhe të ndërmjetëm, janë të hedhura online në platformën Gnomon, e cila është e aksesueshme dhe nga stafi dhe nga studentët. Studentët në mënyrë online mund të ndjekin të gjithë avancimin e tyre akademik.

Bazuar në *nenin 11* të Rregulles për sekretarinë mësimore, është detyrë e sekretarisë të mirëmbajë, ruajë, plotësojë dhe kryejë hedhjen e të dhënave në regjistra. Të dhënat personale mbrohen nga UNYT, në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 9887 mbi mbrojtjen e të dhënave personale. Gjatë vizitës në institucion, GVJ bëri verifikime të regjistrit themeltar, regjistrit të notave, procesverbalëve të provimeve për studentët e kursit. Të dhënat, ishin lehtësisht të disponueshme dhe të verifikueshme.

Evidenca 4.20. Platforma Gnomon

Evidenca 4.16. Politika e mbrojtjes të të dhënave

Evidenca 5.4. Rregullore e brendshme për veprimtarinë e sekretarisë

Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatoam se me vendim të Rektoratit në datë 02.02.2023 është ngritur komisioni ad-hoc për auditimin e brendshëm, për periudhën e kohës 2020 -2022.



Evidenca 6.20. Vedim i Rektoratit për auditim të brendshëm

lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.				
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Departamenti ofrues i programit të studimit, ka të dhëna periodike për ecurinë akademike të studentëve pas çdo semestri. Duke filluar që nga regjistrimi i studentëve, nota mesatare në hyrje, dhe progresi akademik për çdo semestër. Progresi i studentëve është pjesë e raportit vjetor të departamentit dhe i analizës të punës për përmirësim të mëtejshëm të programit të studimit.</p> <p>Programi i studimit nuk ka të diplomuar.</p> <p><i>Evidenca 2.5. Tabela përmbledhëse (tabela 21)</i> <i>Evidenca 1.18. Raporti vjetor i Departamentit</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Të dhënat për programin e studimit janë të plota, të ruajtura konform ligjit 80/2015 dhe ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.</i></p> <p>- <i>Në sekretarinë mësimore janë mirëmbajtur, ruajtur dhe hedhur të dhënat e studentëve të programit të studimit, në regjistrin themeltar, regjistrin e notave dhe procesverbalë të provimeve.</i></p> <p>- <i>Programi i studimit akoma nuk ka të diplomuar.</i></p> <p><i>GVJ konstaton se Departamenti, ka të dhëna periodike të detajuara për ecurinë akademike të studentëve pas çdo semestri. Progresi i studentëve është pjesë e raportit vjetor të departamentit dhe i analizës të punës për përmirësim të mëtejshëm të programit të studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.5</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>




<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Neni 70 i Statutit të UNYT, parashikon pjesëmarrjen e studentëve në qeverisjen akademike. Studentët kanë zërin e tyre në formulimin e politikave të UNYT nëpërmjet Këshillit të Studentëve. Përfaqësimi i tyre është:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Studentët kanë një përfaqësues të zgjedhur nga Këshilli i Studentëve, në Senat; -Studentët kanë një anëtar përfaqësues në Komisionin e Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë. Komisioni ka mandat 2 vjeçar me të drejtë rizgjedhje, neni 32 i Statutit’ -Studentët kanë një anëtar përfaqësues në Këshillin e Etikës të zgjedhur nga Senati akademik; <p><i>Evidenca 1.1. Statuti</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Nga dokumentacioni i dorëzuar dhe vizata në institucion, konstatoam se, përfshirja e studentëve në vendimmarrje, është jo vetëm e përcaktuar në statutin e UNYT, por pjesëmarrja e tyre ka qenë reale. Dokumentacioni provues, Vendimi nr. 81, datë 26.05.2022 i Senatit akademik, për emërimin e përfaqësuesve të studentëve në Senat, Komisionin e Etikës dhe Komisionin e Garantimit të Cilësisë.</p> <p><i>Evidenca 6.19. Përfshirja e studentëve në sigurimin e cilësisë</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Për çdo semestër shpërndahen formularë vlerësimi që plotësohen nga studentët, para fillimit të sezonit të provimeve. Rezultatet e pyetësorëve shpallen pas përfundimit të sezonit të provimeve, me qëllim që të mos ketë mundësi për ndikim në vlerësim.</p> <p>Nga vizita në institucion, konstatoam se në rastin kur në mësimdhënie përfshihej një pedagog i ri, shpërndarja e formularëve realizohej dy herë. Një herë në mes të semestrit dhe një herë në fund. Të dhënat e marra përpunohen nga NJSBC dhe më pas, shkojnë tek Drejtuesi i departamentit në mënyrë të sintetizuar dhe tek çdo pedagog individual, të mbyllura me zarf, duke ruajtur diskrecionin.</p> <p>Gjetjet dhe problemet e evidentuara, diskutohen në mbledhjen e departamentit, janë pjesë e raportit vjetor të punës së departamentit dhe ndihmojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. Gjatë takimit me studentët në institucion, konstatoam se për çdo shqetësim që ata kanë pasur në lidhje me një lëndë të caktuar, e kanë zgjidhur duke diskutuar me pedagogun e lëndës. Nuk kanë pasur nevojë për</p>


	<p>ndihmën e këshilltarit akademik dhe mënyrave të tjera të përcaktuara në rregulloren e programit.</p> <p><i>Evidenca 6.9. Formularë vlerësimi nga studentë</i> <i>Evidenca 1.21. Raporti vjetor i Departamentit</i></p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Nga dokumentacioni si dhe nga vizita në institucion, konstatuam se vlerësimi është bërë në përputhje me përcaktimet e Rregullores së programit të studimit dhe syllabusit të secilës lëndë. Studentët kanë ushtruar të drejtën e tyre për të ankimuar, bazuar në Rregulloren e programit të studimit. Bazuar në dokumentacion, pedicion i datë 01.04.2022, dhe kthimi përgjigje, vendimi akademik datë 7.10.2022)</p> <p>Gjatë takimit me studentë nuk u shpreh asnjë ankesë për drejtësinë në vlerësimim. Studentët u shprehën se: “<i>duhet shumë punë për të ruajtur bursën</i>”.</p> <p><i>Evidenca 5.29. Pedicion akademik</i> <i>Evidenca 5.29.1. Vendim pedicioni</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Studentët janë përfshirë në vendimmarrje në përputhje me ligjin 80/2015, me një përfaqësues në Senat, një përfaqësues në Komisionin e etikës dhe një përfaqësues në Komisionin për garantimin e standarteve të cilësisë.</i></p> <p><i>Institucioni shpërndan në mënyrë periodike pyetësorë, për të marrë mendimin e studentëve për përmirësim të mëtejshëm të mësimdhënies.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrajnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e</p>	<p>Përgjegjës për informimin dhe shërbimin e studentëve në UNYT, është Zyra e çështjeve studentore, e ngritur bazuar në nenin 46 të Rregullores të Universitetit. Zyra mban komunikim</p>

<p>shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>të vazhdueshëm me studentët gjatë tre cikleve të studimit. Detyrat dhe mënyra e funksionimit të kësaj zyre bazohet në rregullore të veçantë.</p> <p><i>Evidenca 1.7. Rregullore e Universitetit</i> <i>Evidenca 5.31. Rregullore e zyrës së marrdhënieve me studentët</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e programit të studimit (neni 18), çdo studenti i përcaktohet një këshillues akademik, në fillim të vitit akademik. Këshilluesi akademik, bazuar në rregullore ka detyrim të takohet minimumi një herë gjatë semestrin në një seancë zyrtare me studentin dhe të plotësojë një formë të veçantë këshilluese, e cila hidhet online në sistemin e - Gnomon. Detyra e këshilluesit akademik është të udhëzojë studentët që të regjistrojnë lëndët, numrin e krediteve që duhet të plotësojë, të ndihmojë studentët në të gjitha çështjet mësimore. Gjatë vizitës në institucion, takimi me studentët, konstatoam se roli i këshilluesit akademik ishte i rëndësishëm për studentët për gjetjen e zgjidhjeve të problemeve lidhur me procesin mësimor.</p> <p><i>Evidenca 1.10. Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 3.2. Detyrat e pedagogëve udhëheqës</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>UNYT bazuar në <i>nenin 54</i> Statutit, ka ngritur Zyrën e alumnai dhe karrierës. Kjo zyrë siguron orientim, mbështetje dhe këshillim për të gjithë studentët dhe të diplomuarit drejt tregut të punës ose që të vijojnë më tej studimet. Zyra është e angazhuar në këshillim të vazhdueshëm karriere, ofron mundësi për studentët për punësim, intership, trajnime dhe shkolla verore/ dimërore, organizon panairin e përvitshëm të punësimit etj.</p> <p>Zyra mban kontakte dhe takime të vazhdueshme me biznese private dhe institucione publike për të ofruar mundësi sa më të mëdha për studentët, për realizimin e praktikave mësimore dhe për punësimin. Zyra mban kontakte të vazhdueshme me kompanitë private/ institucione publike ku studentët po kryejë intership ose janë të punësuar, për të parë përputhjen e aftësive dhe kompetencave të fituara në shkollë me aftësitë dhe kompetencat që kërkohen nga tregu i punës. Kjo shërben për përmirësimin e mëtejshëm të programit të studimit dhe konsiderohet në analizën e punës vjetore të Departamentit.</p>

	<i>Evidenca 1.1. Statuti</i> <i>Evidenca 5.11. Rregullore e zyrës të karrierës</i> <i>Evidenca 5.16. Plani vjetor zyra e karrierës</i> <i>Evidenca 5.18. Feeedback në lidhje me punësimin</i>			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Në këtë program studimi nuk ka studentë të diplomuar.			
Konkluzione	<i>Institucioni ka ngritur struktura, Zyrën e çështjeve studentore, Zyrën e alumni dhe të karrierës të cilat mbajnë kontakte të vazhdueshme me studentët për t'i informuar për mundësi të ndryshme që ata kanë, por dhe për të zgjidhur probleme që mund të hasin gjatë studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR


Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të	Në bazë të dokumentacionit shoqëruar, RVB-së, dhe nga takimet gjatë vizitës në UNYT, konstatohet se UNYT përdor metoda të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. UNYT ka hartuar Strategjinë e mësimdhënies, mësimnxënies dhe metodave të vlerësimit për periudhën 2020-2025 me synim

<p>fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>arritjen e objektivit për ekselencë në mësimdhënie dhe përqaftimin e epokës së re të edukimit. Në këtë strategji parashikohet dhe rishikimi i kurrikulave sipas nevojave të tregut.</p> <p>Nga vizita në institucion dhe takimi me Dekanin, Shefin e Departamentit dhe stafin, u konstatua puna e vazhdueshme përmes shumë hallkave dhe metodave, për trajnimin e stafit të ri dhe përmirësimin e përbashkët të procesit të mësimdhënies. Në funksion të saj, stafi akademik ka kryer dhe mobilitete Erasmus. Gjatë periudhës së pandemisë, UNYT ka mundësuar zhvillimin e kurseve të mësimit online. Janë përdorur platformat si: McGraw Hill dhe PersonMyLab, si dhe është implementuar “e-plaftorma” elektronike, udhëzues për metodat e mësimdhënies, manual për hartimin/riorganizimin e një programi studimi si dhe guida për mësimdhënien online.</p> <p><i>Evidenca 2: RVB Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile “Ekonomiks”, “Financë” dhe “Kontabilitet”</i></p> <p><i>Evidenca 3.1: Manuali i Instrukturëve</i></p> <p><i>Evidenca 6.18: Strategjia e mësimdhënies, mësimnxënies dhe metodave të Vlerësimit</i></p> <p><i>Evidenca 5.25: Shkëmbim stafi Akademik</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>GVJ konstatoi se monitorimi dhe vlerësimit periodik i aftësive mësimdhënëse të personelit akademik realizohet nga bashkëpunimi mes strukturave si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (6 anëtarë staf akademik përfaqësues të fakulteteve dhe një përfaqësues i studentëve); • Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (dy staf administrativ dhe një ekspert i jashtëm); • Fakulteti dhe Departamentet përgjegjëse të programeve të studimit; <p>Komisioni përbëhet nga staf akademik dhe luan funksion politikbërës dhe monitorues të procesit. Kurse NJSBC përbëhet nga staf administrativ, i cili angazhohet me implementimin e procesit.</p> <p>Mekanizmat kryesorë të monitorimit periodik janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i pedagogëve nga studentët; • Raporti i vetëvlerësimit në fillim dhe në fund të vitit; • Vlerësimi i kolegëve; • Analizat e ecurisë të realizuara në nivel Departamenti;

	<p>Gjatë vitit 2019 me ndryshimin e kurrikulave, stafi i sigurimit të cilësisë u angazhua në mbikqyrjen e procesit të aplikimit në ministri si dhe me mbikqyrjen e hartimit të rregulloreve të reja.</p> <p><i>Evidenca 2: RVB Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile "Ekonomiks", "Financë" dhe "Kontabilitet"</i></p> <p><i>Evidenca 6.1: Manual për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë</i></p> <p><i>Evidenca 6.2: Raporti Vjetor NjSBC</i></p> <p><i>Evidenca 6.3: Rregullore për Komisionin e Përhershëm të Sigurimit dhe Standardeve të Cilësisë</i></p> <p><i>Evidenca 6.7: Rregullore për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Studentët plotësojnë pyetësorët në lidhje me vlerësimin e lëndës dhe të pedagogut. Ky vlerësim bëhet para përfundimit të shkollës në orën e mësimit të çdo lënde përkatëse. Në përfundim të pyetësorëve bëhet një raport final, i cili i përcillet rektorit, dekanit, shefit të departamentit dhe profesorëve përkatës.</p> <p>Plotësimi dixhital i pyetësorëve ndihmon dhe përshpejton procesin. Në pyetësor ka hapësira ku studentët mund të shkruajnë komente gjë që ndihmon një vlerësim sa më objektiv.</p> <p>Nga vizita në institucion dhe takimi me Dekanin, Shefin e Departamentit dhe stafin, u konstatua se Strukturat ku studentët mund të bëjnë ankimime të ndryshme fillojnë me pedagogun e lëndës. Nëse nuk gjen zgjidhje i drejtohet këshilluesit akademik. Nëse dhe në këtë rast jo, më tej ndjek rrugën proceduriale ku i drejtohet komisioneve sipas llojit të problemit. Në këtë mënyrë, UNYT përpiqet të sigurojë procesin e sigurisë. Në këtë proces përveç rolit të komisionit të sigurimit të cilësisë (rregulloreve, procedurave, zbatimeve të saktë të procedurave, zbatimit të saktë të instrumentave), një rol të rëndësishëm luan përgjegjësi i departamentit.</p> <p><i>Evidenca 2: RVB Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile "Ekonomiks", "Financë" dhe "Kontabilitet"</i></p> <p><i>Evidenca 1.14: Raport vjetor i Departamentit</i></p> <p><i>Evidenca 5.29: Peticion Akademik</i></p> <p><i>Evidenca 5.29.1: Vendim Peticioni (Administrative)</i></p> <p><i>Shënime gjatë vizitës në institucion</i></p>

<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Nga takimet me stafin e sigurimeve të cilësisë, GVJ konstaton se ka një qëndrueshmëri në ruajtjen e cilësisë së stafit akademik në drejtim të procedurave të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Për sa i përket nivelit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, është përgjegjësi i departamentit i cili duhet të marrë masa aktive dhe të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme.</p> <p>Nëse komentet kanë qenë negative, janë marrë masa, si për shembull: pedagogu është kthyer në pozicionin e tij si asistent pedagog, ose mund t'i jetë hequr lënda pedagogut. Por gjithmonë këto masa kanë qenë shumë të kujdesshme për të ruajtur imazhin e pedagogut. Ka patur komente jo pozitive nga studentët në lidhje me infrastrukturën dhe facilitetet, dhe për këtë arsye UNYT po merr masa për krijimin e kampuseve të reja. Investimet zënë pjesën kryesore të buxhetit.</p> <p><i>Evidenca 2: RVB Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile "Ekonomiks", "Financë" dhe "Kontabilitet"</i></p> <p><i>Shënime gjatë vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, dhe nga dokumentacioni i marrë në dorëzim, rezulton se IAL punon në drejtim të përmirësimit të aftësisë të personelit akademik, duke e nxitur atë në kërkim shkencor në mënyra të ndryshme. Gjithashtu UNYT përdorur instrumenta të kontrollit të cilësisë për vlerësimin e mësimdhënies së stafit akademik. Për promovimin e stafit akademik alokohet një buxhet për pjesëmarrjen në konferenca dhe botime nga stafi akademik me qëllim nxitjen e personelit akademik për përmirësim të mëtejshëm në mësimdhënie.</p> <p><i>Evidenca 2: RVB Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile "Ekonomiks", "Financë" dhe "Kontabilitet"</i></p> <p><i>Evidenca 4.29: Vendim Senati No 67 2020 Promovim Stafi</i></p> <p><i>Evidenca 4.29.1: Vendim Senati No 75 2020 Promovim Stafi</i></p> <p><i>Evidenca 4.31: Fakulteti i Ekonomise dhe Biznesit Plan Buxheti 2022-2023</i></p> <p><i>Evidenca 5.29: Mbeshtetje per aktivitete shkencore</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - UNYT harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies; - Nga takimet me stafin e sigurimeve të cilësisë, GVJ konstaton se ka një qëndrueshmëri në ruajtjen e cilësisë së stafit akademik në drejtim të procedurave të mësimdhënies dhe mësimnxënies;

	<ul style="list-style-type: none"> - Monitorimi dhe vlerësimi periodik i aftësive mësimdhënëse të personelit akademik realizohet nga bashkëpunimi mes strukturave, dhe Mekanizimat kryesorë të monitorimit periodik janë: Vlerësimi i pedagogëve nga studentët; Raporti i vetëvlerësimit në fillim dhe në fund të vitit; Vlerësimi i kolegëve; si dhe Analizat e ecurisë të realizuara në nivel Departamenti; - Për promovimin e stafit akademik alokohet një buxhet për pjesëmarrjen në konferenca dhe botime nga stafi akademik me qëllim nxitjen e personelit akademik për përmirësim të mëtejshëm në mësimdhënie; 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Siç përcaktohet në Statutin e tij dhe Planin Strategjik 2020-2025, UNYT ka krijuar politika dhe procedura të sigurimit të brendshëm të cilësisë, tashmë të konsoliduara dhe në bazë të eksperiencës shumëvjeçare si IAL.</p> <p>Këto politika dhe procedura, ndiqen dhe implementohen nga dy strukturat përgjegjëse që janë KPSSC dhe NJSBC. Për të mbështetur më tej përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, ka hartuar dhe rregulloren e KPSSC, Manualin e Sigurimit të Cilësisë si dhe Rregulloren për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p> <p>Komisioni përbëhet nga staf akademik dhe luan funksion politik bërës dhe monitories të procesit. Kurse NJSBC përbëhet nga staf administrativ i cili merret me implementimin e procesit. Roli i bashkëpunëtorve të jashtëm qëndron në bërjen e opionencës së brendshme të procesit ndihmon në hartimin e rregullores, manualit, statutit, rishikimin e pyetësorit ka ndihmuar në trajnimin e stafit që merret me sigurimin e cilësisë.</p>

	<p><i>Evidenca 1.1: Statuti UNYT</i></p> <p><i>Evidenca 1.6: Plani Strategjik 2020-2025</i></p> <p><i>Evidenca 6.1: Manual për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë</i></p> <p><i>Evidenca 6.3: Rregullore për Komisionin e Përhershëm të Sigurimit dhe Standardeve të Cilësisë</i></p> <p><i>Evidenca 6.7: Rregullore për NJSBC</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Prej vitit 2012 UNYT ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Cilësisë dhe Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë me qëllim sigurimin e cilësisë në UNYT. Njsbc funksionon bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë, Statutin e Institucionit, Rregulloret specifike si dhe Manualin e Sigurimit të Cilësisë.</p> <p>KPSSC është institucionalizuar si një strukturë organizative në UNYT përmes ngritjes dhe funksionimit të strukturave të përhershme dhe për sigurimin e standardeve të cilësisë së institucionit. Ky komision është i kompozuar prej 6 anëtarë të stafit akademik dhe një përfaqësues student, i cili siguron dhe monitoron cilësinë e mësimdhënies në bashkëpunim me Njsbc e cila është e kompozuar me 2 anëtar të stafit administrativ dhe një ekspert i jashtëm me profil akademik.</p> <p><i>Evidenca 1.1: Statuti UNYT</i></p> <p><i>Evidenca 6.1: Manual për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë</i></p> <p><i>Evidenca 6.3: Rregullore për Komisionin e Përhershëm të Sigurimit dhe Standardeve të Cilësisë</i></p> <p><i>Evidenca 6.7: Rregullore për NJSBC</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>UNYT dhe Programi i studimit Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile “Ekonomiks”, “Financë” dhe “Kontabilitet” i është nënshtruar procesit të akreditimit të jashtëm në bazë të parashikimeve dhe përcaktimeve ligjore.</p> <p>UNYT u riakreditua institucionalisht nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, në bazë të vendimit të Bordit të Akreditimit Nr.61, datë 18.12.2020, me dy rekomandime:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Institucioni, të përfshijë më shumë studentë, në varësi të ciklit të studimit, në kërkim shkencor, projekte kërkimore dhe programet e shkëmbimit; 2. Intitucioni, të fuqizojë më tej rrjetin alumni dhe të rrisë përfshirjen e tij në sigurimin e brendshëm të cilësisë; <p>Në lidhje me përmbushjen e rekomandimeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt programit të studimit, është 4 studentë, (Tabelat përmbledhëse,

	<p>tabela 20). Dy studentë janë angazhuar në punime shkencore të pedagogëve, 11 studentë janë angazhur në projekte shkencore në rang Departamenti, 48 studentë janë angazhuar në projekte shkencore në rang Fakulteti (Tabelat përmbledhëse, tabela 22);</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e komisionit të përhershëm për sigurimin e standartave të cilësisë, bazuar në nenin 4 pika 2, ka në përbërje të saj një student. Nuk ka specifikime për angazhimin e alumnit; <p>UNYT ka përdorur instrumentet e duhura të sigurimit të cilësisë për të siguruar cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënit. Instrumenti institucional është Manuali i Sigurimit të Cilësisë, i cili është dokumenti bazë për KPSSC të institucionit. Nga vizita në institucion dhe takimet e kryera me stafin e sigurimit të cilësisë, GVJ konstatoi një bashkëpunim shumë të mirë midis dy komisioneve për një performancë më të mirë në plotësimin dhe ndjekjen e rekomandimeve nga akreditimi, për mbikqyrjen e procesit të aplikimit në ministri si dhe me mbikqyrjen e hartimit të rregulloreve të reja, gjatë ndryshimit të kurrikulave në vitin 2019. Për këtë program studimi nuk ka një plan-veprim duke qenë se po akreditohet për herë të parë.</p> <p><i>Evidenca 0: Leje dhe Akreditime</i></p> <p><i>Evidenca 1.1: Statuti UNYT</i></p> <p><i>Evidenca 6.1: Manual për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë</i></p> <p><i>Evidenca 6.3: Rregullore për Komisionin e Përhershëm të Sigurimit dhe Standardeve të Cilësisë</i></p> <p><i>Evidenca 6.7: Rregullore për NJSBC</i></p> <p><i>Evidenca 6.12: Akreditimi Institucional i UNYT_VBA nr. 61 date 18.12.2020</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Siç GVJ evidentoi dhe më lart, monitorimi dhe vlerësimi periodik i aftësive mësimdhënëse të personelit akademik realizohet nga bashkëpunimi mes strukturave, të cilat aplikojnë forma të ndryshme të vlerësimit, në bazë të të cilave mund të llogariten tregues të matshëm.</p> <p>Mekanizimat kryesorë të monitorimit periodik janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i pedagogëve nga studentët; • Raporti i vetëvlerësimit në fillim dhe në fund të vitit; • Vlerësimi i kolegëve; • Analizat e ecurisë të realizuara në nivel Departamenti.

	<p>Për promovimin e stafit akademik alokohet një buxhet për pjesëmarrjen në konferenca dhe botime nga stafi akademik me qëllim nxitjen e personelit akademik për përmirësim të mëtejshëm në mësimdhënie.</p> <p><i>Evidenca 2: RVB Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile "Ekonomiks", "Financë" dhe "Kontabilitet"</i></p> <p><i>Evidenca 6.1: Manual për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë</i></p> <p><i>Evidenca 6.2: Raporti Vjetor NjSBC</i></p> <p><i>Evidenca 6.3: Rregullore për Komisionin e Përhershëm të Sigurimit dhe Standardeve të Cilësisë</i></p> <p><i>Evidenca 6.7: Rregullore për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>UNYT ka ngritur struktura dhe hartuar politika/procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë;</i> - <i>Monitorimi dhe vlerësimi periodik i aftësive mësimdhënëse të personelit akademik realizohet përmes disa mekanizmave, mbi bazën e të cilave bëhet dhe promovimi i stafit;</i> <p><i>UNYT u riakreditua institucionalisht nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, në bazë të vendimit të Bordit të Akreditimit Nr.61, datë 18.12.2020, kurse Programi i studimit Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile "Ekonomiks", "Financë" dhe "Kontabilitet" po akreditohet për herë të parë, pasi është program i ri.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin	Nga vizita në institucion dhe takimet e kryera me stafin e sigurimit të cilësisë, GVJ konstaton se UNYT ka ngritur struktura dhe hartuar politika/procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Monitorimi dhe vlerësimi periodik i aftësive mësimdhënëse të personelit akademik realizohet

<p>dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>përmes disa mekanizmave, si: Vlerësimi i pedagogëve nga studentët; Raporti i vetëvlerësimit në fillim dhe në fund të vitit; Vlerësimi i kolegëve; dhe Analizat e ecurisë të realizuara në nivel Departamenti.</p> <p>NJSBC zhvillon dy herë në vit pyetësorin i cili plotësohet nga studentët në lidhje me mësimdhënien. NJSBC pasi përfundon hedhjen e të dhënave të pyetësorëve në sistemin SEEvaluation, përpunon raportin përfundimtar dhe bën të njohur me rezultatet e këtij vlerësimi Rektoratin, Dekanët e Fakultetit, Përgjegjësit e Departamentit si dhe rezultati i dërgohet secilit profesor në mënyrë elektronike.</p> <p><i>Evidenca 2: RVB Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile "Ekonomiks", "Financë" dhe "Kontabilitet"</i></p> <p><i>Evidenca 6.1: Manual për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë</i></p> <p><i>Evidenca 6.2: Raporti Vjetor NjsBC</i></p> <p><i>Evidenca 6.3: Rregullore për Komisionin e Përhershëm të Sigurimit dhe Standardeve të Cilësisë</i></p> <p><i>Evidenca 6.7: Rregullore për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>KPSSC në bashkëpunim me NjsBC ne bazë të raporteve jep rekomandime/sugjerime për përmirësimin e pikave të dobëta që ka Institucioni. NjsBC është në komunikim të vazhdueshëm me departamentet përkatëse dhe e gatshme për implementimin e përmirësimin e praktikave mësimore. Instrumentet e shumta si pyetësorë me studentët, stafin akademik, fokus grupet, etj. shërbejnë për marrjen e një feedback-u me qëllim ndërhyrjen dhe përmirësimin e cilësisë nëse është e nevojshme.</p> <p>Në rastin e rezultateve pozitive, stafi motivohet duke e mbështetur financiarisht në botime apo pjesëmarrje në konferenca. Gjithashtu nga takimet me stafin GVJ konstaton se në bazë të ecurisë së stafit, bëhet dhe promovimi i tij në pozicione drejtuese apo anëtarë komisionesh.</p> <p><i>Evidenca 4.29: Vendim Senati No 67 2020 Promovim Staf</i></p> <p><i>Evidenca 6.9: Formular Vlerësimi nga Studentët</i></p> <p><i>Evidenca 2: RVB Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile "Ekonomiks", "Financë" dhe "Kontabilitet"</i></p> <p><i>Shënime gjatë vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të</p>	<p>UNYT, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të</p>


<p>realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>drejtpërdrejta nëpërmjet të cilave merr informacion mbi vlerësimin e kurrikulave, planit mësimor, metodave didaktike të mësimdhënies, vlerësimin e ecurisë dhe angazhimin e studentëve në programin e studimit, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i pedagogëve nga studentët; • Raporti i vetëvlerësimit në fillim dhe në fund të vitit; • Vlerësimi i kolegëve; • Analizat e ecurisë të realizuara në nivel Departamenti. <p>Gjithashtu, UNYT ka marrë iniciativa për rishikim të kurrikulave me qëllim përmirësimin e programit të studimit. Përditësimi i kurrikulave është bërë duke u bazuar në kërkesat e studentëve si dhe duke studiuar nevojat e tregut të punës, përgjegjësit e departamenteve në bashkëpunim me anëtarët e departamenteve kanë propozuar dhe iniciuar ndryshime përkatëse më pak se 20%.</p> <p><i>Evidenca 1.14: Raporti vjetor i Departamentit _ Viti Akademik 2020-2021</i></p> <p><i>Evidenca 1.15: Vlerësimi i Performances Individuale 2020-2021</i></p> <p><i>Evidenca 1.18: Raporti vjetor i Departamentit _ Viti Akademik 2021-2022</i></p> <p><i>Evidenca 1.19: Raporti i NJSBC për Vlerësimin e Transparences- Departamenti Ekon&Fin. _2020- 2021</i></p> <p><i>Evidenca 1.19.1: UNYT Raporti i NJSBC për Vlerësimin e Transparences- Departamenti Ekon&Fin _Fall2021 _SP22</i></p> <p><i>Evidenca 2.2: Strategjia e Studimit te Tregut</i></p> <p><i>Evidenca 6.9.1: Vlerësimet e Pedagoqeve nga studentet - Spring 2021</i></p> <p><i>Shënime gjatë vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që</p>	<p>Për Programin e studimit Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile “Ekonomiks”, “Financë” dhe “Kontabilitet”, ende nuk ka të dhëna për studentë të diplomuar, pasi brezi i parë i studentëve nuk janë diplomuar akoma.</p> <p><i>Shënime gjatë vizitës në institucion</i></p>

bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.				
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se UNYT ka ngritur struktura dhe hartuar politika/procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Monitorimi dhe vlerësimi periodik i aftësive mësimdhënëse të personelit akademik realizohet përmes disa mekanizmave. Instrumentet e shumta si pyetësorë me studentët, stafin akademik, fokus grupet, etj. shërbejnë për marrjen e një feedback-u me qëllim ndërhyrjen dhe përmirësimin e cilësisë nëse është e nevojshme.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>UNYT ka ngritur struktura dhe ka hartuar politika/procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. UNYT ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Cilësisë dhe Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë me qëllim sigurimin e cilësisë në UNYT. Njësitë funksionojnë bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë, Statutin e Institucionit, Rregulloret specifike si dhe Manualin e Sigurimit të Cilësisë.</p> <p><i>Evidenca 1.1: Statuti UNYT</i></p> <p><i>Evidenca 6.1: Manual për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë</i></p> <p><i>Evidenca 6.3: Rregullore për Komisionin e Përhershëm të Sigurimit dhe Standardeve të Cilësisë</i></p> <p><i>Evidenca 6.7: Rregullore për NJSBC</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë</p>	<p>Komisioni dhe njësia varen nga senati dhe çdo propozim ia drejtojnë senatit. Komisioni ka ndihmuar në inkorporimin e praktikave ekzistuese me praktikat e reja. Komisioni ka pasur rol aktiv në hartimin e këtyre rregulloreve, të cilat më pas i janë</p>






<p>të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>përcjellë përgjegjësve përkatës për programet përkatëse të studimit. Kur është bërë rishikimi i kurrikulës, puna kryesore është realizuar në departament, është konsultuar me ekspert të jashtëm, është marrë mendimi i studentëve se cilat kanë qenë lëndët më të vlefshme për ta nga programi i katërvjeçarit. Kurse NJSBC ka qenë ura lidhëse midis komisionit dhe ministrisë për dërgimin e saktë dhe në kohën e duhur të dokumentave. Komisioni është marrë dhe me standartizimin e sylabuseve në vite, gjithashtu është marrë dhe me përcaktimin e nivelit të gjuhës angleze.</p> <p><i>Shënime gjatë vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>UNYT siguron cilësinë e programeve të studimit nëpërmjet punës së bashkërenduar të NJSBC, KPSSC me qëllim sigurimin e cilësisë në UNYT. NJSBC dhe departamenteve përgjegjëse. KPSSC është i kompozuar prej 6 anëtarë të stafit akademik dhe një përfaqësues student, i cili siguron dhe monitoron cilësinë e mësimdhënies në bashkëpunim me NJSBC e cila është e kompozuar me 2 anëtar të stafit administrativ dhe një ekspert i jashtëm me profil akademik.</p> <p><i>Evidenca 1.1: Statuti UNYT</i></p> <p><i>Evidenca 6.1: Manual për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë</i></p> <p><i>Evidenca 6.3: Rregullore për Komisionin e Përhershëm të Sigurimit dhe Standardeve të Cilësisë</i></p> <p><i>Evidenca 6.7: Rregullore për NJSBC</i></p> <p><i>Evidenca 6.5: Vendim rektorati nr. 99 ekspert i jashtëm</i></p> <p><i>Evidenca 6.19: Përfshirja e studentëve në sigurimin e cilësisë</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se pyetësorët dhe mekanizmat e tjerë të përdorur në procesin e sigurimit të cilësisë nuk çenojnë lirinë akademike dhe integritetin akademik të personelit dhe studentëve. Ruhet privatësia e informacionit dhe e rezultateve që sigurohen nga veprimtaria e tyre dhe anonimat i studentëve që plotësojnë formularët e vlerësimit.</p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e</p>	<p>Roli i bashkëpunëtorve të jashtëm qëndron në bërjen e oponentëve të brendshme të procesit ndihmon në hartimin e rregullores, manualit, statutit, rishikimin e pyetësorit ka ndihmuar në trajnimin e stafit që merret me sigurimin e cilësisë. Gjithashtu, në fazën hartimit/ rishikimit të programeve të studimit në vitin 2019, UNYT në disa raste ka bashkëpunuar</p>





<p>studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>me ekspertë të jashtëm të fushës në mënyrë për të ofruar një përfaqje më të përshtatshme me tregun e punës.</p> <p>Gjithashtu UNYT është i vëmendshëm në plotësimin e sugjerimeve dhe rekomandimeve të lëna nga ekspertët e jashtëm të ASCAL, gjatë vlerësimeve periodike të procesit të akreditimit të programeve të studimit, dhe akreditimit Institucional.</p> <p><i>Evidenca 6.5: Vendim rektorati nr. 99 ekspert i jashtëm</i> <i>Evidenca 6.2: Raporti Vjetor NjSBC 2020-2021</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - UNYT ka ngritur struktura dhe ka hartuar politika/procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë; - UNYT siguron përfshirjen e stafit akademik dhe të studentëve në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit; <p><i>UNYT përfshin ekspertëve të jashtëm në procesin e vlerësimit të cilësisë dhe jo vetëm. Edhe procesi i rishikimit të kurrikulave ndihmohet me ekspertë të jashtëm, por mungojnë evidence të këtyre takimeve.</i></p>		
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.5</p> <p>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>UNYT ka hartuar politikat dhe procedurat në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për të gjitha programet e studimit dhe i ka dokumentuar ato në Manualin e Sigurimit të Cilësisë, Statutin dhe Rregulloren e UNYT-së, të cilat janë të disponueshme për të gjitha palët e interesit.</p>

<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>UNYT bën publike në web të gjitha vlerësimet e programeve si dhe vlerësimin për akreditimin institucional.</p> <p>Rezultatet e vlerësimit të pedagogëve nga studentët dhe kolegët adresohen në mënyrë të kujdesshme, duke ruajtur etikën dhe konfidencialitetin. Gjithashtu, vlerësimet e studentëve përpunohen në mënyrë elektronike dhe konkluzionet si dhe komentet u bëhen publike pedagogëve përkatës pasi lënda të ketë përfunduar plotësisht duke ruajtur konfidencialitetin. NjSBC pasi përfundon hedhjen e të dhënave të pyetësorëve në sistemin SEEvaluation, përpunon raportin përfundimtar dhe bën të njohur me rezultatet e këtij vlerësimi Rektoratin, Dekanët e Fakultetit, Përgjegjësit e Departamentit si dhe rezultati i dërgohet secilit profesor në mënyrë elektronike.</p> <p><i>Evidenca 2: RVB Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile "Ekonomiks", "Financë" dhe "Kontabilitet"</i></p> <p><i>Evidenca 6.1: Manual për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë</i></p> <p><i>Evidenca 6.2: Raporti Vjetor NjSBC</i></p> <p><i>Evidenca 6.3: Rregullore për Komisionin e Përhershëm të Sigurimit dhe Standardeve të Cilësisë</i></p> <p><i>Evidenca 6.7: Rregullore për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>NJSBC është në komunikim të vazhdueshëm me departamentet përkatëse dhe e gatshme për implementimin e përmirësimin e praktikave mësimore. Instrumentet e shumta si pyetësorë me studentët, stafin akademik, fokus grupet, etj. shërbejnë për marrjen e një feedback-u me qëllim ndërhyrjen dhe përmirësimin e cilësisë nëse është e nevojshme.</p> <p>KPSSC në bashkëpunim me NjSBC ne bazë të raporteve jep rekomandime/sugjerime për përmirësimin e pikave të dobëta që ka Institucioni. Në rastin e rezultateve pozitive, stafi motivohet duke e mbështetur financiarisht në botime apo pjesëmarrje në konferenca. Gjithashtu nga takimet me stafin GVJ konstaton se në bazë të ecurisë së stafit, bëhet dhe promovimi i tij në pozicione drejtuese apo anëtarë komisionesh.</p> <p><i>Evidenca 4.29: Vendim Senati No 67 2020 Promovim Stafi</i></p> <p><i>Evidenca 6.9: Formular Vleresimi nga Studentet</i></p>

	<p><i>Evidenca 2: RVB Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile "Ekonomiks", "Financë" dhe "Kontabilitet"</i></p> <p><i>Shënime gjatë vizitës në institucion</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se UNYT në bazë të eksperiencës së gjatë, ka krijuar kulturën e vlerësimit, përmes ndërgjegjësimit të të gjithë aktorëve.</p> <p>Departamenti përgjegjës për këtë program studimi analizon periodikisht ecurinë dhe problematikat e procesit mësimor, punën kërkimore-shkencore, angazhimin administrativ, aktivitetet me studentët si dhe përcaktohen objektivat për vitin e ardhshëm akademik në funksion të përmirësimit të vijueshëm të cilësisë. Në bashkëpunim të ngushtë me departamentin përgjegjës, bashkërendojnë punën e tyre NJSBC dhe KPSSC me qëllim përditësimin e vijueshëm të të gjithë palëve të interesit dhe për të nxitur pjesëmarrjen aktive të tyre në procesin e përmirësimit afatgjatë të cilësisë së programeve të studimit.</p> <p><i>Evidenca 2: RVB Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile "Ekonomiks", "Financë" dhe "Kontabilitet"</i></p> <p><i>Evidenca 1.18: Raporti vjetor i Departamentit _ Viti Akademik 2021-2022</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p><i>Evidenca 2: RVB Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile "Ekonomiks", "Financë" dhe "Kontabilitet"</i></p> <p><i>Evidenca 1.18: Raporti vjetor i Departamentit _ Viti Akademik 2021-2022</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>UNYT ka hartuar politikat dhe procedurat në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për të gjitha programet e studimit, të cilat janë të disponueshme për të gjitha palët e interesit;</i> - <i>Rezultatet e vlerësimit të pedagogëve nga studentët dhe kolegët adresohen në mënyrë të kujdesshme, duke ruajtur etikën dhe konfidencialitetin;</i> - <i>UNYT në bazë të eksperiencës së gjatë, ka krijuar kulturën e vlerësimit, përmes ndërgjegjësimit të të gjithë aktorëve;</i> 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
---	--	-------------------------------------	------------------------------------	---

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Ekonomiks dhe Financë me profile: Ekonomiks, Financë dhe Kontabilitet

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi aktual i studimit, është ngritur bazuar në eksperiencën a mëparshme të fituar në mësimdhënie nga bashkëpunimi me Universitetin Shtetëror të New York/ Empire State College, duke ruajtur praktikat më të mira si dhe mësimdhënien në gjuhën angleze;
2. Staf i akademik i angazhuar në këtë program studimi është i qendrueshëm, kompetent dhe ka të gjitha kualifikimet e nevojshme për lëndët që mbulon;
3. UNYT promovon stafin akademik duke alokuar një buxhet të konsiderueshëm për kërkim shkencor me qëllim nxitjen e personelit akademik për përmirësim të mëtejshëm në mësimdhënie;
4. UNYT në bazë të eksperiencës së gjatë, ka krijuar kulturën e vlerësimit, përmes ndërgjegjësimit të të gjithë aktorëve;
5. Programi i studimit bachelor ndiqet dhe nga studentët të huaj, jo në kuadër të programeve të shkëmbimit Erasmus;
6. Programi i studimit i pajis studentët me njohuri shumë të mira në përpunimin e të dhënave dhe ndërtimin e parashikimeve duke i bërë studentët më konkurrues në tregun e punës;
7. Praktika mësimore zhvillohet në vitin e dytë të studimit, duke bërë që studentët të kenë mundësi të praktikojnë njohuritë e fituara, para përfundimit të studimeve;
8. Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës ndjek nga afër ecurinë e studentëve që zhvillojnë praktika profesionale dhe konsideron opinionin e punëdhënësve në analiza periodike për përmirësim të mëtejshëm të programit të studimit;
9. Përdorimi i platformës kundërplagjaturës, garanton drejtësi në vlerësimin e punëve të studentëve si gjatë vitit akademik ashtu edhe për detyrimet përmbyllëse;
10. Programi i studimit i ka përfshirë studentët në konkurse ndërkombëtare, ku ata dhe janë shpallur fitues;
11. UNYT ka ambiente të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor. Infrastruktura dhe teknologjia është mëse e përshtatshme për programin e studimit;
12. UNYT granton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit, përmes donacioneve nga Fondacioni Turk Maarif;

b. Pika të dobta:

1. Teoria zë një peshë të konsiderueshme më të madhe sesa orët praktike në programin e studimit; (*Standardi II.4, kriteri 3*)
2. Literatura bazë dhe ajo plotësuese nuk është e përditësuar në një pjesë të konsiderueshme të lëndëve që ofrohen nga programi i studimit; (*Standardi II.4, kriteri 5*)

3. Programi i studimi, nuk ka të parashikuar ngritjen e komisioneve për vlerësimin e projektit të diplomës dhe provimeve; (*Standardi III.2, kriteri 1*)

Rekomandime:

1. Rekomandojmë që raporti teori praktikë të rishikohet për të tre profilet, duke rritur peshën e orëve praktike në syllabus;
2. Universiteti duhet të rrisë investimet për përditësimin e literaturës bazë dhe plotësuese për programin e studimit;
3. Rekomandojmë që për projektin e diplomimit të ngrihen komisione për mbrojtje dhe të mos vlerësohet vetëm nga pedagogu drejtues;
4. Rekomandojmë që të rishikohen orët jashtë auditorit dhe të vendoset një lidhje e drejtpërdrejtë midis ngarkesës të lëndës në auditor dhe krediteve që lënda ka;
5. Zëri komponentë të tjerë, që ka një peshë 20% në vlerësim, të specifikohet për të gjitha syllabuset e lëndëve;
6. Të rriten përpjekjet (marketingu) nga institucioni me qëllim rritjen e numrit të studentëve në programin e studimit. Numri i ulët i studentëve të regjistruar është kërcënim për stabilitetin financiar afat gjatë të programit;

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor in Economics and Finance with profile "Economics", "Finance" and "Accounting"

a. Strengths and affirmations:

1. The study program is based on previous teaching experience gained from collaboration with State University of New York/ Empire State College, preserving the best practices of teaching in English language;
2. The academic staff of the study program (both full time and part time) is stable, competent, and have all the necessary qualifications for the classes it covers;
3. UNYT has allocated a considerable budget to promote the research of academic staff and to improve further their teaching skills;
4. UNYT has created a culture of evaluation based on the long experience through the awareness of all the actors;
5. The study program is followed by international students, not in the framework of exchange programs such as Erasmus;
6. The study program develops advanced skills in data analysis and forecasting that make the students more competitive in the labor market;
7. Professional practice is scheduled in the second year of study, creating possibility for the students to apply their knowledge before the end of their study;




8. The Department of Economics and Finance follows closely the professional practice and considers the feedback of employers for further improvements of the study program;
9. The use of anti-plagiarism platform, guaranty justice in evaluation of students' course works during academic year, as well as their final thesis;
10. The students of this study program are involved in international competition and have won prizes;
11. UNYT has sufficient and suitable classrooms and facilities for teaching process and other student activities. The infrastructure and technology in support of teaching program is updated;
12. UNYT has gained financial stability for teaching programs through the donations of Maarif Foundation from Tukey;

b. Weaknesses:

1. The theoretical teaching hours in this study program dominate the practical teaching hours in all the three profiles; (*Standard II.4, criteria 3*)
2. The obligatory literature and additional literature are not updated for a considerable number of courses; (*Standard II.4, criteria 5*)
3. In the regulation of the study program, is not defined setting up commission for graduation thesis and exams evaluation; (*Standard III.2, criteria 1*)

Recommendation

1. We recommend adjusting the theoretical teaching hours and practical teaching hours, by increasing the weight of practical teaching hours;
2. The university should increase investment for updating the literature both obligatory and additional;
3. We recommend that the final thesis to be evaluated by a commission and not only by the academic adviser;
4. We recommend reconsidering the individual studying hours for all the courses to have a fair link between teaching hours and the number of credits (ECTS) that a course has;
5. In all the syllabuses "other components" that account for 20% of final grade, should be determined how are estimated;
6. The institution should increase the effort (marketing) to increase the number of students in the study program. The low number of registered students is a threat for the long run financial stability;



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X